ANALIZË POLITIKASH

PENGESAT STRUKTURORE DHE POLITIKAT NXITËSE PËR SIPËRMARRJEN E GRAVE NË SHQIPËRI

UK International Development
Partnership | Progress | Prosperity

UN WOMEN

FOR ALL WOMEN AND GIRLS

©2026 UN Women.

Ky botim është i disponueshëm për përdorim të hapur, në përputhje me licencën Creative Commons të krijuar për organizatat ndërqeveritare, e cila gjendet në: https://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/3.0/igo/

Botuesit duhet të fshijnë logot e UN Women dhe qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar nga botimet e tyre dhe të krijojnë një dizajn të ri për ballinën e tyre.

Botuesit duhet ta dërgojnë dokumentin e botimit të tyre me email në adresën: permissions@unwomen.org

Fotokopje dhe riprodhime të pjesëve të materialit lejohen me kusht citimin e duhur të burimit. Ky publikim është përgatitur nga UN Women Shqipëri, në kuadër të projektit "Investo te Gratë: Përshpejtimi i Progresit drejt Barazisë Gjinore në Shqipëri", i zbatuar nga UN Women me mbështetjen financiare të Qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar.

Publikuar nga UN Women Shqipëri, Tiranë, 2026. Lutemi që këtë botim ta citoni si: UN Women, 2026. "Pengesat Strukturore dhe Politikat Nxitëse për Sipërmarrjen e Grave në Shqipëri". Pikëpamjet e shprehura në këtë botim janë të autoreve dhe jo domosdoshmërisht përfaqësojnë pikëpamjet e UN Women, të qeverisë së Mbretërisë së Bashkuar ose të ndonjë prej organizatave të lidhura me to.

ANALIZË POLITIKASH

PENGESAT STRUKTURORE DHE POLITIKAT NXITËSE PËR SIPËRMARRJEN E GRAVE NË SHQIPËRI

GJETJE DHE REKOMANDIME KRYESORE, ME FOKUS TË VEÇANTË TE GRATË NË SIPËRMARRJET E VOGLA DHE TE GRATË E PAFAVORIZUARA DHE TË MARGJINALIZUARA

UN Women Shqipëri

Maj 2026

MIRËNJOHJE

Ky raport është hartuar nga Prof. Asoc. Dr. Fatma Jaupi, Eksperte e UN Women, dhe ka përfituar nga rishikimi dhe kontributet thelbësore të Michele Ribotta, Përfaqësues i UN Women Shqipëri, Irena Beqja Shtraza, Koordinatore Projekti pranë UN Women Shqipëri; Jetona Myteveli, Eksperte e UN Women Shqipëri dhe Vasilika Laçi, Menaxhere Programi pranë Ambasadës Britanike në Tiranë.

Analiza ka përfituar gjithashtu nga kontributet e vlefshme të përfaqësueseve e përfaqësuesve nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Agjencia Shtetërore për Zhvillimin e Ekosistemit të Startup-eve në Shqipëri, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), Bashkia Tiranë, Rrjeti Shqiptar për Zhvillimin Rural, Qendra Balance dhe Nisma ARSIS.

UN Women shpreh mirënjohjen e sinqertë për të gjitha gratë sipërmarrëse nga sektorë të ndryshëm, të cilat ndanë bujarisht kohën, përvojat dhe ekspertizën e tyre përmes konsultimeve dhe plotësimit të pyetësorit. Kontributet dhe këndvështrimet e tyre të vlefshme kanë qenë thelbësore në hartimin e kësaj analize dhe të rekomandimeve të politikave të paraqitura në këtë raport.

UK International Development
Partnership | Progress | Prosperity

UN WOMEN

FOR ALL WOMEN AND GIRLS

TABELA E PËRMBAJTJES

1. Përmbledhje ekzekutive 8

2. Hyrje 10

2.1 Sfondi dhe konteksti i politikave 11

2.2 Qëllimi dhe objektivat 12

2.3 Objekti i dokumentit 13

3. Metodologjia dhe qasja analitike 14

4. Kuadri politik, ligjor dhe institucional për sipërmarrjen e grave në Shqipëri 17

5. Shqyrtimi i të dhënave mbi sipërmarrjen e grave në Shqipëri 23

6. Pengesat strukturore që ndikojnë në sipërmarrjen e grave në Shqipëri 29

7. Përfundime dhe përmbledhje e gjetjeve kryesor 35

8. Mesazhi kryesor i politikave 39

Shtojcat 44

Shtojca 1. Praktikat e mira ndërkombëtare 45

1.1 Qëllimi i analizës së përvojës ndërkombëtare 45

1.2 Modele dhe shembuj të praktikave të mira 45

1.3 Mësime për Shqipërinë 47

1.4 Mundësia për transferim dhe për përshtatje për Shqipërinë 47

Shtojca 2: Përmbledhje e tryezës së konsultimit me palët e interesuara, 24 prill 2026 48

Bibliografia 51

LISTA E TABELAVE

Tabela 1: Sipërmarrje në pronësi të grave me 1-4 punonjës/e 24

LISTA E FIGURAVE

Figura 1: Sipërmarrjet në pronësi të grave sipas sektorëve të biznesit në Shqipëri, 2024 25

Figura 2: Sipërmarrjet në pronësi të grave sipas sektorëve të biznesit në Shqipëri, 2021–2024 26

Figura 3: Shkalla e përjashtimit nga punësimi sipas grupeve të pafavorizuara, gratë shqiptare, 2022–2023 27

Figura 4: Arsyet pse biznesi juaj mbetet i vogël 32

Figura 5: Sa ndikojnë përgjegjësitë familjare dhe ngarkesa e punës në shtëpi në biznesin tuaj? 33

Figura 6: A hasni më shumë pengesa në biznes sesa burrat? 34

LISTA E SHKURTIMEVE

AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
SZHBI	Strategjia për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave
BERZH	Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim
KE	Komisioni Europian
EAQ	Europa dhe Azia Qendrore (zyra rajonale e UN Women)
FSE	Fondi Social Europian
BE	Bashkimi Europian
EU GAP III	Plani i Veprimit të BE-së për Barazinë Gjinore III
FVDBGJ	Fondi i Veprimit për Drejtësi dhe Barazi Gjinore
TIK	Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit
ONP	Organizata Ndërkombëtare e Punës
INSTAT	Instituti i Statistikave (Shqipëri)
IPA	Instrumenti i Asistencës së Para-Anëtarësimit
SHPFP	Shkalla e Pjesëmarrjes në Forcën e Punës
NMVM	Ndërmarrje mikro, të vogla dhe të mesme
AKPA	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive
NEET	Jashtë Punësimit, Arsimit ose Formimit Profesional
SKBGJ	Strategjia Kombëtare për Barazi Gjinore
OECD	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
S3	Strategjia e Specializimit Inteligjent
ABV	Administrata e Biznesit të Vogël (Shtetet e Bashkuara)
NVM	Ndërmarrje të Vogla dhe të Mesme
OKB	Kombet e Bashkuara
KKBTZH	Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Tregtinë dhe Zhvillimin
PNUD	Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim
TZHB	Treguesit e Zhvillimit Botëror (Banka Botërore)
PFG	Parimet e Fuqizimit të Grave

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Kjo analizë politikash shqyrton pengesat strukturore që ndikojnë në sipërmarrjen e grave në Shqipëri dhe identifikon drejtimet kryesore të politikave për të forcuar një ekosistem me sipërmarrje më të afta, gjithëpërfshirëse dhe më të përgjigjshme gjinore.

Ai u kushton vëmendje të veçantë grave që drejtojnë sipërmarrje mikro dhe të vogla dhe grave të pafavorizuara dhe të margjinalizuara, duke përfshirë gratë në zonat rurale, gratë rome dhe egjiptiane, gratë me aftësi të kufizuara, gratë me nivele të ulëta arsimimi, gratë në punë informale dhe gratë me përgjegjësi të mëdha kujdesi të papaguar. Analiza mbështetet në një shqyrtim të dokumenteve të legjislacionit, kuadrove të politikave, statistikave zyrtare, vlerësimeve të mëparshme, gjetjeve të konsultimeve me palët e interesuara dhe përgjigjeve të anketës me gratë sipërmarrëse.

Dokumenti konstaton se sipërmarrja e grave në Shqipëri është e dukshme dhe në rritje, por mbetet e kufizuar nga pikëpamja strukturore në drejtim të madhësisë, pozicionimit në sektorëdhe mundësisë për rritje. Gratë përbënin 31,4% të sipërmarrjeve aktive në vitin 2024, ndërsa sipërmarrjet në pronësi të grave ose të menaxhuara nga gratë të regjistruara rishtazi gjatë vitit përfaqësonin 32,0% të të gjitha sipaërrmarrjeve të reja. Në të njëjtën kohë, bizneset e drejtuara nga gratë mbeten kryesisht të përqendruara në ndërmarrjet e vogla: rreth 89% e sipërmarrjeve në pronësi të grave bëjnë pjesë në kategorinë me 1-4 punonjës. Bizneset në pronësi të grave janë gjithashtu të përqendruara në tregti, shërbime të tjera dhe veprimtari akomodimi dhe ushqimi, teksa mbeten të nënpërfaqësuara në sektorë të tillë si ndërtimi, transporti dhe industria, ku shpesh gjenden mundësi më të forta produktiviteti dhe zgjerimi.
Analiza e politikave identifikon një sërë pengesash të ndërlidhura strukturore. Përjashtimi nga ndihma financiare mbetet pengesa më e rëndësishme, ku shumë gra mbështeten në kursimet personale ose mbështetjen nga familja dhe raportojnë vështirësi të mëdha për të marrë kredi bankare. Përgjegjësitë e kujdesit të papaguar vazhdojnë të kufizojnë kohën, lëvizshmërinë dhe mundësitë e grave për të investuar në rritjen e biznesit. Këto kufizime përforcohen nga aksesi i dobët në rrjete, tregje dhe marketing, pjesëmarrja e pabarabartë në mbështetjen digjitale, në zhvillimin e biznesit dhe në marketing dhe kompleksiteti institucional në orientimin drejt skemave të regjistrimit, tatimeve, formalizimit dhe mbështetjes publike. Dokumenti gjithashtu zbulon se këto pengesa nuk janë të shpërndara në mënyrë të njëtrajtshme: gratë që përballen me disavantazhe të ndërthurura përjetojnë përjashtim më të thellë si nga tregu i punës ashtu edhe nga ekosistemi i mbështetjes së sipërmarrjes.

Analiza vëren se Shqipëria ka bërë përparim të rëndësishëm në forcimin e mjedisit formal politik dhe ligjor përmes Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030, Strategjisë së Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021–2027, Strategjisë Kombëtare për Zhvillimin e Sipërmarrjes Inovative 2024–2030 dhe legjislacionit të forcuar për barazinë gjinore të miratuar në vitin 2025. Megjithatë, zbatimi mbetet jo i njëtrajtshëm dhe sipërmarrja e grave ende nuk mbështetet me një kuadër operativ mjaftueshëm koherent, me synim të qartë dhe të matshëm. Mosrinovimi Planit Kombëtar të Veprimit të dedikuar për Sipërmarrjen e Grave pas vitit 2020 ka lënë një hendek të rëndësishëm, ndërsa raportimi i dobët i ndarë sipas gjinisë vijon të kufizojë llogaridhënien në të gjitha programet mbështetëse.

Mesazhi kryesor politik i dokumentit është se Shqipëria duhet të shkojë përtej një qasjeje të përgjithshme të mbështetjes së sipërmarrjes dhe të miratojë një model mbështetjeje të synuar, të përgjigjshëm gjinor dhe të matshëm për sipërmarrjet mikro dhe të vogla të drejtuara nga gratë, me vëmendje të veçantë ndaj grave të pafavorizuara

dhe të margjinalizuara. Në terma praktikë, kjo kërkon akses më të mirë në financim, shërbime më të forta mbështetëse lokale, monitorim sistematik të ndarë sipas gjinisë dhe përdorim më të efektshëm të platformave ekzistuese për akses në treg, mentorim dhe ndërmjetësim në biznes. Dokumenti gjithashtu thekson rëndësinë e rrugëve të synuara të rikualifikimit dhe të përmirësimit të aftësive për gratë e zhvendosura nga sektorët në rënie, veçanërisht industria e fasonerisë, dhe të marrëveshjeve më elastike të punësimit me kohë të pjesshme që do të ndihmonin bizneset e vogla të zgjeroheshin gradualisht, duke hapur më shumë mundësi pune për gratë me përgjegjësi kujdesi.

Analiza argumenton se sipërmarrja e grave duhet të trajtohet jo si një çështje sociale periferike, por si një çështje thelbësore për zhvillimin gjithëpërfshirës, pjesëmarrjen në ekonomi, barazinë gjinore dhe reformën institucionale. Një model më praktik dhe më i synuar mbështetjeje do të forconte sipërrmarrjet e drejtuara nga gratë, do të përmirësonte përfshirjen e zhvillimit ekonomik në nivel vendor dhe do të ndihmonte Shqipërinë të përkthente angazhimet formale të politikave në rezultate më të besueshme dhe të matshme.

HYRJE

2. HYRJE

2.1 SFONDI DHE KONTEKSTI I POLITIKAVE

Sipërmarrja e grave në Shqipëri nuk është vetëm një çështje e krijimit të biznesit ose pjesëmarrjes në tregun e punës. Ajo është gjithashtu e lidhur ngushtë me barazinë gjinore, përfshirjen sociale dhe aftësinë e institucioneve për të ofruar mbështetje të drejtë dhe të efektshme. Kur gratë janë në gjendje të fillojnë, të mbajnë dhe të rrisin bizneset, përfitimet shkojnë përtej sipërmarrjes individuale. Ato kontribuojnë në rritjen e mirëqenies së familjes, forcimin e ekonomisë vendore dhe rritjen e zhvillimit kombëtar më gjithëpërfshirës. Shqipëria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në vitet e fundit për të përmirësuar mjedisin për gratë sipërmarrëse. Kuadri i politikave për barazinë gjinore është bërë më i fortë dhe masat mbështetëse për zhvillimin e biznesit janë zgjeruar. Këto janë zhvillime pozitive dhe tregojnë rritjen enjohjessë rolit të grave në ekonomi. Në të njëjtën kohë, të dhënat vazhdojnë të tregojnë se gratë mbeten të nënpërfaqësuara në pronësinë e sipërrmarrjeve dhe sipërmarrjen e orientuar drejt rritjes, dhe se ky hendek është më i thellë për gratë që përballen me forma të ndryshme të disavantazhit (KE, 2024) [1], (KE, 2025) [2].

Statistikat e fundit zyrtare tregojnë se ka pasur disa përparime, por pabarazia është ende qartësisht e pranishme. Sipas botimit të fundit të INSTAT-it (INSTAT, 2025)[3] me të dhëna në fusha të ndryshme të jetës, të ndara sipas gjinisë, gratë përfaqësonin 50,5% të popullsisë banuese në Shqipëri në fund të vitit 2024. I njëjti botim tregon se, midis personave të moshës 15-64 vjeç, burrat mbeten dukshëm më të pranishëm në tregun e punës sesa gratë, me shkallë pjesëmarrjeje prej 82,3% për burrat dhe 69,3% për gratë. Gjithashtu ai tregon se 28,5% e grave janë punëtore pa pagesë në biznesin e familjes dhe se 14,0% grave deklarojnë se janë inaktive në tregun e punës, duke përmbushur detyrat shtëpiake, krahasuar me vetëm 0,4% të burrave. Hendeku gjinor në paga u raportua në 4,9% në vitin 2024 (INSTAT, 2024)[4]. Këto shifra tregojnë pabarazi gjinore strukturore që lidhen me pjesëmarrjen në tregun e punës, të ardhurat, përgjegjësitë e kujdesit dhe pavarësinë ekonomike që formësojnë drejtpërdrejt mundësitë e grave për sipërmarrje.

Të dhënat për sipërmarrjen paraqesin një model të ngjashëm. Regjistrat e Biznesit të vitit 2024 të INSTAT, të botuar në vitin 2025[5], raportojnë 132.172 sipërmarrje aktive në Shqipëri (duke përjashtuar fermerët e regjistruar), nga të cilat 41.512, ose 31,4% ishin në pronësi ose të menaxhuara nga gratë. Ndër ndërmarrjet e regjistruara rishtazi gjatë vitit 2024, 5.103 nga 15.970 të tilla, ose 32,0%, ishin në pronësi ose të menaxhuara nga gratë. Këto shifra tregojnë se gratë janë vazhdimisht të pranishme në sipërmarrjen shqiptare, por ende larg barazisë. Ato gjithashtu tregojnë se sipërmarrja e grave luan një rol domethënës në ekonomi, ndërsa ende përballet me kufizime në aspektin e madhësisë, shtrirjes dhe mundësive për rritje të qëndrueshme.

Anketa e vitit 2023 për gratë sipërmarrëse në Shqipëri (GADC, 2023)[6] theksoi më tej se shumë gra sipërmarrëse mbështeten në kursimet familjare për të filluar një biznes, se shumica nuk kanë aplikuar për kredi bankare dhe se trajnimi,

1. European Commission, COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT Albania 2024 Report https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/a8eec3f9-b2ec-4cb1-8748-9058854dbc68_en?filename=Albania+Report+2024.pdf
2. European Commission, Commission Staff Working Document Albania 2025 Report. https://enlargement.ec.europa.eu/document/download/fe9138b7-90fe-4277-a12c-3a03f6d1957f_en?filename=albania-report-2025.pdf
3. INSTAT, 2025. Gratë dhe Burrat në Shqipëri 2025. https://www.instat.gov.al/media/f4lhllkw/women-and-men-in-albania-2024.pdf
4. INSTAT. (2024). Tregu i Punës në Shqipëri 2024. https://www.instat.gov.al/media/ebwma5bq/tregu_i_punes_2024_final.pdf
5. INSTAT. (2025). Regjistrat e Biznesit 2024. https://www.instat.gov.al/media/lgud2dk1/regjistrat-e-biznesit-2024.pdf
6. QAGJZH (GADC).(2023). "Vlerësimi i Mjedisit për Sipërmarrjen e Grave" në Shqipëri: Një studim për gratë sipërmarrëse në Shqipëri. www.gadc.org.al

përdorimi digjital dhe planifikimi formal i biznesit mbeten jo të njëtrajtshëm. I njëjti studim nënvizoi gjithashtu se Shqipëria ka pasur vetëm një Plan Veprimi të dedikuar për Sipërmarrjen e Grave, që mbulon periudhën 2014-2020, pa një plan veprimi pasues të identifikuar në kuadrin rregullator të rishikuar.

Kjo analizë politikash adreson gjithashtu nga situata specifike e grave të pafavorizuara dhe të margjinalizuara. Censi i Popullsisë dhe Banesave i vitit 2023[7] nxori në pah se 24,3% e familjeve në Shqipëri kanë një grua kryefamiljare. Në praktikë, shumë gra në familje të tilla mbajnë përgjegjësi të njëkohshme për krijimin e të ardhurave, kujdesin e papaguar dhe vendimmarrjen në familje, shpesh me akses më të dobët në prona, financim dhe mbështetje institucionale. Këto kufizime janë edhe më të mprehta për gratë kryefamiljare, gratë rurale, gratë në punë informale, gratë nga familje të varfra, gratë me aftësi të kufizuara, gratë rome dhe egjiptiane, gratë e reja jashtë rrugëve formale të punësimit ose arsimimit, dhe gratë me akses të dobët në pronë ose kolateral.

Kuadri i politikave është duke evoluar, por mbetet ende i paplotë. Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 e vendos fuqizimin ekonomik të grave midis shtyllave të saj kryesore dhe i jep përparësi grupeve të cenueshme dhe përfshin aktivitete që lidhen me promovimin e sipërmarrjes së grave. Përveç kësaj, Strategjia e Zhvillimit të Biznesit dhe Investimeve 2021–2027 ofron një bazë të rëndësishme për mbështetjen e rritjes së sipërmarrjeve. Megjithatë, ka ende hapësirë për të forcuar më tej integrimin e masave të përgjigjshme gjinore për të siguruar rezultate të forta dhe të matshme për gratë sipërmarrëse. Shqipëria ka futur gjithashtu Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Sipërmarrjes Inovative 2024–2030, duke treguar ripërtëritjen e angazhimit të qeverisë ndaj sipërmarrjes dhe inovacionit. Sfida kryesore tani është të sigurohet që kjo përpjekje më e gjerë për ndërtimin e ekosistemit të rezultojë në përfitime gjithëpërfshirëse për gratë, veçanërisht ato që përballen me pengesat më të mëdha për pjesëmarrje.

Nga perspektiva e anëtarësimit në BE, kjo agjendë vjen në kohën e duhur. Raporti i Komisionit Europian për Shqipërinë 2024 deklaroi se kuadri ligjor dhe institucional i Shqipërisë për barazinë gjinore është pjesërisht në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe standardet europiane, ndërsa zbatimi mbetet ende një dobësi. Raporti për Shqipërinë 2025 vuri në dukje më tej se ligji për barazinë gjinore ruan një nivel të lartë ambicieje për të qenë në përputhje me standardet e BE-së, duke përforcuar se çështja kryesore nuk është më vetëm angazhimi formal ligjor, por edhe zbatimi i efektshëm, bashkërendimi institucional dhe efekti i matshëm. Në këtë kuptim, sipërmarrja e grave ndodhet në kryqëzimin e barazisë gjinore, konkurrueshmërisë, përfshirjes sociale dhe reformave në sektorin publik.

7. INSTAT. (2024). Censi i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri 2023. Rezultatet kryesore. https://www.instat.gov.al/media/13615/cens-i-popullsise-2023.pdf

2.2 QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi i kësaj analizë politikash është të vlerësojë se sa mbështetës është mjedisi aktual në Shqipëri për gratë në biznes, me një fokus të veçantë te gratë që drejtojnë sipërmarrje të vogla (1-4 punonjës/e). Ai gjithashtu synon të identifikojë masa që mund të ndihmojnë më shumë gra të marrin pjesë në sipërmarrje në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme, veçanërisht për gratë nga grupet e margjinalizuara të cilat shpesh përballen me pengesa më të mëdha. Dokumenti shqyrton të dhënat e disponueshme dhe vlerësimet e mëparshme për gratë në biznes, identifikon pengesat kryesore strukturore me të cilat ato përballen dhe shqyrton praktikat e mira ndërkombëtare që mund të jenë të rëndësishme për Shqipërinë. Mbi bazën e këtyre, dokumenti propozon rekomandime praktike dhe të zbatueshme për institucionet kombëtare dhe vendore. Kjo qasje e vë drejtpërdrejt theksin në masat e institucioneve për lehtësimin e procesit, në përafrimin me legjislacionin e BE-së dhe vëmendjen më të madhe ndaj grave të pafavorizuara dhe të margjinalizuara.

2.3 OBJEKTI I ANALIZËS

Analiza përqendrohet në disa aspekte të sipërmarrjes së grave në Shqipëri, duke përfshirë fillimin e biznesit, formalizimin, funksionimin, rritjen, aksesin në financim, në shërbime mbështetëse dhe lehtësimin e procesit nga institucionet. Ajo nuk i trajton gratë sipërmarrëse si një kategori homogjene. Në vend të kësaj, analiza përdor një këndvështrim gjithëpërfshirës që u kushton vëmendje të veçantë grave që përballen me disavantazhe të ndërthurura, përfshirë varfërinë, disavantazhin territorial, barrën e kujdesit të papaguar, pronësinë e dobët mbi pronën, përjashtimin nga tregu i punës, informalitetin, aftësinë e kufizuar, përjashtimin për shkak të etnisë dhe aksesin më të ulët në mbështetje institucionale. Përveç kësaj, dokumenti përqendrohet në sipërmarrjet e vogla në pronësi të grave që përballen me sfida në financimin dhe drejtimin afatgjatë të biznesit të tyre. Dokumenti gjithashtu përdor një perspektivë qeverisjeje. Sipërmarrja e grave varet jo vetëm nga aftësitë individuale, por edhe nga cilësia e kuadrit ligjor, reagimi i institucioneve, aksesi në financim, funksionimi i strukturave vendore të zhvillimit ekonomik dhe disponueshmëria e të dhënave të besueshme të ndara sipas gjinisë. Kësisoj, analiza shkon përtej prirjeve përshkruese dhe shqyrton se si rregulloret e institucioneve dhe hartimi i politikave ose i zvogëlojnë, ose i shumëfishojnë pengesat për gratë sipërmarrëse.

METODOLOGJIA DHE QASJA ANALITIKE

3. METODOLOGJIA DHE QASJA ANALITIKE

Kjo analizë politikash mbështetet në metodën e analizës cilësore dhe të mbështetur në dokumente, duke kombinuar shqyrtimin e të dhënave të disponueshme me angazhimin e strukturuar të palëve të interesuara dhe mbledhjen e të dhënave të anketave me fokus gratë në ndërmarrje mikro dhe të vogla. Qasja pasqyron objektivin e dyfishtë të dokumentit: të prodhojë një vlerësim të mjedisit mundësues për sipërmarrjen e grave dhe të prodhojë rekomandime të zbatueshme, specifike për institucionet, me vëmendje të veçantë për gratë e pafavorizuara dhe të margjinalizuara.

3.1 SHQYRTIMI I LEGJISLACIONIT, STRATEGJIVE, DOKUMENTEVE TË POLITIKAVE DHE TË DHËNAVE TË DISPONUESHME

Shtylla kryesore analitike e dokumentit është një shqyrtim i strukturuar i dokumenteve, që mbulon tri fusha të ndërlidhura. Së pari, shqyrtimi analizon legjislacionin dhe politikat kombëtare që rregullojnë sipërmarrjen dhe barazinë gjinore në Shqipëri. Kjo përfshin Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030, Strategjinë për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve 2021–2027, Strategjinë Kombëtare për Zhvillimin e Sipërmarrjes Inovative 2024–2030 dhe legjislacionin përkatës për regjistrimin e biznesit dhe veprimtarinë ekonomike. Kërkesat e legjislacionit të BE-së dhe standardet e përputhshmërisë, duke përfshirë Raportet e Komisionit Europian për Shqipërinë për vitet 2024 dhe 2025, janë integruar në të gjitha dokumentet e mësipërme si një kuadër vlerësues. Së dyti, shqyrtimi mbështetet në të dhëna sasiore nga burime zyrtare statistikore. Burimi kryesor i të dhënave është seria e "Regjistrave të Biznesit" të INSTAT-it (2021–2024), regjistra të cilat ofrojnë të dhëna të ndara sipas gjinisë mbi pronësinë, madhësinë dhe shpërndarjen e sipërmarrjeve sipas sektorëve.

Kjo plotësohet nga "Tregu i Punës 2024" i INSTAT-it, "Censi i Popullsisë dhe Banesave 2023" dhe botimi i përvitshëm "Burrat dhe gratë në Shqipëri 2024". Kur është e rëndësishme, këto grupe të dhënash kombëtare kontekstualizohen përkundrejt standardeve krahasuese të BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, duke përfshirë të dhëna nga ONP-ja, Portali i të Dhënave Gjinore i Bankës Botërore, Këshilli për Bashkëpunim Rajonal, etj.

Së treti, analiza përfshin vlerësime dhe hulumtime të mëparshme mbi sipërmarrjen e grave në Shqipëri. Anketa e vitit 2023 e zhvilluar nga Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim (GADC, 2023) mbi mjedisin për sipërmarrjen e grave ofron një bazë të rëndësishme për aksesin në financime, trajnime dhe shërbime për zhvillimin e biznesit. Materiali analitik shtesë është nxjerrë nga shqyrtimi i kuadrit "Drejt një ekosistemi sipërmarrës gjithëpërfshirës gjinor" dhe nga literatura ndërkombëtare mbi praktikat e mira.

3.2 PËRDORIMI I TË DHËNAVE TË MËPARSHME TË UN WOMEN NGA EXPO 2025

Një grup i dytë i të dhënave mbështeten në njohuritë e gjeneruara përmes programeve të vetë UN Women Albania, në veçanti të nismës "EXPO për sipërmarrjen e grave", e cila është organizuar çdo vit që nga viti 2023. Ekspozita ofron një platformë që bashkon bizneset e drejtuara nga gratë, partnerë/et institucionalë, aktorë/et financiarë dhe organizatat ndërkombëtare rreth temave të modeleve gjithëpërfshirëse të biznesit, aksesit në financim dhe zhvillimit ekonomik të përgjigjshëm gjinor. Njohuritë e nxjerra nga komentet e pjesëmarrës/eve, dialogu i partnerë/eve dhe modelet e vëzhguara në kuadrin e nismës "EXPO për sipërmarrjen e grave", bëjnë të mundur analizën e pengesave në Seksionin 6 dhe mbështesin disa nga rekomandimet e hartuara në këtë dokumet për institucionet. Këto të dhëna trajtohen si cilësore dhe me natyrë eksperimentale, duke plotësuar të dhënat sasiore dhe të dokumenteve të politikave të mbledhura përmes analizës së dokumenteve.

3.3 TRYEZË E RRUMBULLAKËT KONSULTIMI ME PALËT E INTERESUARA DHE REZULTATET E ANKETËS

Komponenti i tretë metodologjik është një tryezë e rrumbullakët konsultimi të strukturuar me shumë palë të interesuara, e organizuar në kuadër të këtij dokumenti politikash dhe e lehtësuar nga UN Women Albania. Tryeza e rrumbullakët mblodhi së bashku përfaqësues/e të institucioneve qeveritare kombëtare dhe vendore, të sektorit privat, organizatave të shoqërisë civile, grave sipërmarrëse dhe partnerë/eve ndërkombëtarë për zhvillim. Qëllimi i saj ishte të konfirmonte dhe thellonte gjetjet që rezultonin nga shqyrtimi i dokumenteve, të identifikonte pengesat dhe faktorët nxitës për zbatimin dhe të testonte rëndësinë dhe mundësitë për zbatiminn e rekomandimeve të propozuara para finalizimit. Tryeza e rrumbullakët u organizua më 24 prill 2026 dhe gjetjet e saj kryesore janë integruar në Seksionin 6 (analiza e pengesave) dhe Seksionin 7 (përfundime dhe rekomandime). Përveç kësaj, është kryer një anketë dhe analiza përfshin 64 përgjigje.

Gjatë gjithë analizës, dokumenti përdor një qasje të ndërthurur. Kjo do të thotë se ai pranon që gratë sipërmarrëse nuk janë të gjitha në të njëjtën situatë dhe se pengesat me të cilat përballen mund të jenë shumë të ndryshme në varësi të vendit ku jetojnë, nivelit të të ardhurave, etnisë, aftësisë së kufizuar, moshës, arsimimit dhe përgjegjësive familjare. Për këtë arsye, dokumenti nuk shqyrton vetëm mjedisin e përgjithshëm të biznesit. Ai gjithashtu merr në konsideratë situatën specifike të grupeve të tilla si gratë rome dhe egjiptiane, gratë në zonat rurale, gratë në punë informale dhe gratë e reja që ndodhen jashtë punësimit dhe arsimimit. Këto janë grupe për të cilat masat e përgjithshme të politikave shpesh nuk funksionojnë po aq mirë.

KUADRI POLITIK, LIGJOR DHE INSTITUCIONAL PËR SIPËRMARRJEN E GRAVE NË SHQIPËRI

4. KUADRI POLITIK, LIGJOR DHE INSTITUCIONAL PËR SIPËRMARRJEN E GRAVE NË SHQIPËRI

Kuadri i Shqipërisë për sipërmarrjen e grave është ndërtuar mbi tri fusha të ndërlidhura të politikave: ligjet dhe strategjitë për zhvillimin e biznesit dhe sipërmarrjeve, institucionet dhe programet që mbështesin bizneset dhe kuadri ligjor dhe politik për barazinë gjinore. Të marra së bashku, këto fusha ofrojnë një kuadër të fortë formal. Megjithatë, mbeten ende sfida, veçanërisht për integrimin e plotë të perspektivës gjinore, sigurimin e zbatimit të efektshëm dhe trajtimin e nevojave specifike të grave të pafavorizuara dhe të margjinalizuara.

4.1. LEGJISLACIONI, STRATEGJITË DHE POLITIKAT KOMBËTARE PËR SIPËRMARRJEN DHE KUADRI I ZHVILLIMIT TË BIZNESIT DHE SIPËRMARRJEVE

Instrumenti kryesor strategjik për politikën e sipërrmarrjeve dhe investimeve është Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Biznesit dhe Investimeve 2021–2027 (SKZHBI 2021–2027). SKZHBI 2021–2027 përbën bazën për pajtueshmërinë e Shqipërisë me Kapitullin 20 të legjislacionit të BE-së mbi Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale. Kapitulli 20, në kuadrin e Grupkapitullit 3 të Anëtarësimit në BE (Konkurrueshmëria dhe Rritja Gjithëpërfshirëse), kërkon që Shqipëria të krijojë dhe zbatojë një politikë të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse industriale dhe të NVM-ve në përputhje me standardet e BE-së, dhe të demonstrojë kapacitet të mjaftueshëm administrativ për bashkëpunim ndërmjet institucioneve (Komisioni Europian, 2024). SKZHBI 2021–2027 përfshin sipërmarrjen e grave si një komponent dhe autorizon Agjencinë Shqiptare të Zhvillimit të Investimeve (AIDA) të ndërmarrë një monitorim dhe mbledhje të të dhënave në mënyrë sistematike.

Elementi më i fundit strategjik i shtuar në peizazhin e politikave të sipërmarrjeve është Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Sipërmarrjes Inovative 2024–2030. Strategjia identifikon tri shtylla: ekosistemin sipërmarrës inovativ, sektorët strategjikë të përafruar me Strategjinë e Specializimit Inteligjent (S3) dhe zhvillimin gjithëpërfshirës (Qeveria e Shqipërisë, 2024b). Shtylla e zhvillimit gjithëpërfshirës krijon, të paktën në parim, një hapje të politikës për zbatimin e perpsektivës gjinore. Megjithatë, strategjia nuk përmban objektiva specifike, instrumente të dedikuara ose tregues monitorimi për gratë sipërmarrëse, dhe nuk bën asnjë referencë ndaj pengesave të veçanta me të cilat përballen grupet e pafavorizuara dhe të margjinalizuara. Nga perspektiva e përafrimit me BE-në, kjo është një mundësi e humbur: Raporti i Komisionit Europian i vitit 2024 për Shqipërinë vlerësoi se Shqipëria ka një nivel të moderuar përgatitjeje për politikën e ndërmarrjeve dhe industrisë sipas Kapitullit 20, duke vënë në dukje se zbatimi i SKZHBI 2021–2027 është në vazhdim, por se progresi mbetet i pjesshëm, veçanërisht në lidhje me dimensionin gjinor të mbështetjes së NVM-ve (Komisioni Europian, 2024).

Një risi e rëndësishme në kuadrin legjislativ të sipërmarrjeve është ligji nr. 25/2022 "Për Mbështetjen dhe zhvillimin e startup-eve" dhe ndryshimet e tij të vitit 2023, të cilat së bashku përbëjnë kuadrin e parë ligjor të Shqipërisë të dedikuar ekosistemit të bizneseve të reja. Ligji u ndryshua më pas në maj 2023 për të krijuar Agjencinë Kombëtare për Bizneset e Reja Inovative, "Startup Albania". "Startup Albania" vepron si një qendër e vetme për ekosistemin e bizneseve të reja, menaxhon skemën e granteve, administron pasaportën e bizneseve të reja, mirëmban portalin zyrtar online dhe është ngarkuar me promovimin ndërkombëtar të bizneseve të reja shqiptare. Një dispozitë veçanërisht e rëndësishme e kuadrit ligjor është se kriteret e pranimit për të përfituar grante përfshijnë në mënyrë të qartë fuqizimin e të rinjve, vajzave dhe grave sipërmarrëse si një objektiv kualifikues për mbështetje financiare, së bashku me ndikimin në mjedis, fushat prioritare të inovacionit dhe përfshirjen sociale (Qendra e Politikave të Investimeve, KKBTZH, 2022).

Kjo e bën ligjin për bizneset e reja instrumentin e vetëm brenda kuadrit legjislativ të sipërmarrjeve që i emërton në mënyrë të qartë gratë si një grup përfitues prioritar. Megjithatë, në praktikë, kuadri mbetet i orientuar drejt sipërmarrjeve që përdorin intensivisht inovacionin dhe drejtohen nga teknologjia dhe për këtë arsye është strukturalisht i largët nga realiteti i sipërmarrjeve të vogla që karakterizon shumicën dërrmuese të sipërmarrjes së grave në Shqipëri.

Regjistrimi i biznesit është thjeshtuar në mënyrë progresive përmes platformës digjitale "e-Albania", e cila tani ofron më shumë se 1.200 shërbime publike edhe për biznesin dhe mundëson regjistrimin online të shoqërive (Qeveria e Shqipërisë, 2024a). Ndërsa nga ky thjeshtim përfitojnë të gjithë sipërmarrësi/et, hendeku i vazhdueshëm i qasjes digjitale midis zonave urbane dhe rurale dhe niveli më i ulët i aftësive digjitale midis grave me nivel të ulët arsimimi ose të paarsimuara, do të thotë që këto përfitime nuk shpërndahen në mënyrë të barabartë.

4.2 PROGRAMET DHE INSTITUCIONET MBËSHTETËSE PËRKATËSE

Aktori kryesor institucional për mbështetjen e NVM-ve dhe lehtësimin e investimeve është AIDA, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, e krijuar sipas ligjit nr. 10303, datë 15 korrik 2010, në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Mandati i AIDA-s përfshin tërheqjen e investimeve të huaja, konkurrueshmërinë e NVM-ve, promovimin e eksporteve dhe shërbimet për mbështetjen e biznesit. Ajo administron katër skema grantesh të financuara nga shteti që synojnë nxitjen e konkurrueshmërisë, ekonominë krijuese, startup-et dhe inovacionin, dhe ofron shërbime jofinanciare duke përfshirë analizën e tregut, rrjetëzimin, modele për planet e biznesit, trajnime dhe udhëzime për certifikimin e eksporteve (Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, pa datë). Në thirrjen e saj të vitit 2025 për aplikime për grante për NMVM-të, AIDA renditi në mënyrë të qartë fuqizimin e sipërmarrëseve gra midis objektivave të deklaruara për mbështetje financiare, së bashku me zhvillimin e produkteve, konkurrueshmërinë dhe inovacionin (Albania Tech, 2025). Kjo përfaqëson një përfshirje operative, megjithëse josistematike, të gjinisë brenda arkitekturës së granteve të AIDA-s. Megjithatë, një kufizim i rëndësishëm është se nuk ka një dritare të dedikuar financimi, ndarje minimale ose flukse specifike të pranueshmërisë për sipërmarrjet mikro dhe të vogla në pronësi të grave ose të drejtuara nga gratë, dhe nuk ka të dhëna të ndara sipas gjinisë të disponueshme publikisht mbi përfituesit e programeve të AIDA-s. Kjo e bën të pamundur vlerësimin nëse gratë sipërmarrëse (dhe veçanërisht ato nga grupe të pafavorizuara) në të vërtetë kanë akses dhe përfitojnë nga instrumentet e AIDA-s me norma të krahasueshme me kolegët e tyre burra.

Një shtyllë e dytë kryesore institucionale është Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), e cila zbaton Strategjinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive 2023–2030. Strategjia synon të përshtatë aftësitë e fuqisë punëtore me nevojat e tregut të punës dhe të promovojë punësimin gjithëpërfshirës, me një fokus të qartë te grupet e cenueshme, përfshirë gratë

dhe të rinjtë (Fondacioni Europian i Trajnimeve). AKPA administron programe aktive të tregut të punës, rrugët e formimit profesional dhe Planin e Zbatimit të Garancisë Rinore 2023–2024. Teksa mandati i saj kryesor është punësimi dhe jo sipërmarrja, programet e AKPA-së krijojnë një linjë të rëndësishme për sipërmarrëset e mundshme gra, veçanërisht ato që bëjnë pjesë në kategorinë NEET(gra që ndodhen jashtë arsimit, punësimit apo formimit profesional) ose gratë me kualifikime arsimore zyrtare të kufizuara. Në nivel vendor dhe ndërkufitar, AIDA mori pjesë si partnere zbatimi në programin "Aftësi për punë Shqipëri-Mali i Zi (IPA II, 2014–2020)", duke synuar posaçërisht gratë dhe të rinjtë e papunë të moshës 15–29 vjeç për trajnim për sipërmarrje dhe për mbështetje për fillimin e biznesit në bashkitë në veri të Shqipërisë (Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, pa datë). Programi "EU4Innovation (2023–2026)", i financuar nga Sida dhe i zbatuar nga "Partners Albania", nisi një "Sfida për fonde" në nëntor 2023 që përfshinte në mënyrë të qartë promovimin e punësimit dhe vetëpunësimit të grave dhe të të rinjve mes objektivave të tij (Partners Albania, 2023). Programi "Gratë në biznes" i Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe pasardhësi i tij, programi "Gratë në biznes në Ballkanin Perëndimor", Faza II (EFSD+), kanë vepruar gjithashtu në Shqipëri, duke ofruar akses në financa, shërbime këshillimi dhe mentorim posaçërisht për NVM-të e drejtuara nga gratë. Ky program përfaqëson instrumentin më të institucionalizuar të aksesit në financim për gratë sipërmarrëse që janë aktualisht aktive në vend (Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim, 2025).

Pavarësisht këtij numri programesh, një kufizim i vazhdueshëm strukturor është se mbetet një pikë e dobët mbledhja e të dhënave të ndara sipas gjinisë në të gjithë mekanizmat mbështetës institucionalë. Mungesa e të dhënave sistematike dhe të ndara sipas gjinisë për përfituesi/et e granteve të AIDA-s, programet e trajnimit të AKPA-së dhe skemat mbështetëse për bizneset e reja do të thotë se nuk është e mundur të përcaktohet, vetëm në bazë të të dhënave administrative, nëse gratë sipërmarrëse përfitojnë nga sistemet publike të mbështetjes në raport me madhësinë e tyre në popullsinë e biznesit, apo nëse gratë e pafavorizuara - rome dhe egjiptiane, rurale, me nivel të ulët arsimimi ose të paarsimuara, ose me përgjegjësi kujdesi - arrihen në mënyrë të efektshme nga ndonjë prej instrumenteve ekzistuese.

4.3 LEGJISLACIONI, STRATEGJITË DHE POLITIKAT QË LIDHEN ME BARAZINË GJINORE DHE RËNDËSIA E TYRE PËR SIPËRMARRJEN E GRAVE

Kuadri legjislativ dhe i politikave të barazisë gjinore në Shqipëri është forcuar ndjeshëm gjatë dekadës së fundit, e nxitur nga një kombinim i angazhimeve të brendshme për reforma dhe detyrimeve të anëtarësimit në BE në kapituj të shumtë të legjislacionit. Të kuptuarit e arkitekturës përkatëse të kapitujve është thelbësore për pozicionimin e sipërmarrjes së grave brenda agjendës së përafrimit me BE-në. Kapitulli 19 i legjislacionit të BE-së (Politika Sociale dhe Punësimi), i cili mbulon direktivat e barazisë gjinore, përfshirë Direktivën 2006/54/KE për trajtimin e barabartë midis grave dhe burrave në punësim dhe profesion, përcakton standardet minimale për pagë të barabartë, sigurimet shoqërore në punë dhe mosdiskriminimin në vendin e punës, duke përfshirë personat e vetëpunësuar dhe pronarë/et e bizneseve (Eurochild, 2025). Kapitulli 23 (Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore) kërkon respektim të plotë të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, Kartës së BE-së për të Drejtat Themelore, Konventës së Stambollit të Këshillit të Europës dhe Konventës së OKB-së për "Eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave" (Konventa CEDAW). Pajtueshmëria me Kapitullin 23 është e lidhur drejtpërdrejt me kuadrin legjislativ të barazisë gjinore, përfshirë mbrojtjen kundër diskriminimit në punësim, aksesin e pabarabartë në kredi bankare dhe mbrojtjen kundër përjashtimit institucional që ndikojnë drejtpërdrejt në pjesëmarrjen e grave në sipërmarrje (CRCA Albania, 2025; Eurochild, 2025). Kapitulli 20 (Ndërmarrjet dhe Politikat Industriale) mbart rëndësinë e vet gjinore: legjislacioni i BE-së kërkon

që politikat për NVM-të dhe instrumentet për mbështetjen e ndërmarrjeve të jenë në përputhje me parimin e mundësive të barabarta, dhe standardi i përkohshëm për mbylljen e Kapitullit 20 për Shqipërinë kërkon posaçërisht që politika për NVM-të të jetë e plotë dhe gjithëpërfshirëse (Komisioni Europian, 2024).

Ligji themelor i barazisë gjinore, ligji nr. 9970, datë 24 korrik 2008 "Për barazinë gjinore në Shoqëri", krijoi mekanizmin kombëtar të barazisë gjinore, futi kuotat gjinore për pozicionet publike të zgjedhura dhe të emëruara, kërkoi vlerësime të ndikimit gjinor te projektligjet dhe krijoi bazën ligjore për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor (Republika e Shqipërisë, 2008b). Një zhvillim legjislativ i rëndësishëm ishte miratimi i ligjit të ri "Për barazinë gjinore" nga Parlamenti i Shqipërisë në nëntor 2025, duke zëvendësuar dhe përmirësuar ndjeshëm kuadrin e vitit 2008 (Republika e Shqipërisë, 2025). Ligji i ri është drejtpërdrejt i rëndësishëm për sipërmarrjen e grave në tre aspekte. Së pari, ai i zgjeron detyrimet e barazisë gjinore në mënyrë të qartë për shoqëritë dhe punëdhënësit e sektorit privat për herë të parë, duke mbyllur një hendek të gjatë në të cilin dispozitat kundër diskriminimit zbatoheshin kryesisht për institucionet publike (Citizens.al, 2025). Së dyti, ai njeh zyrtarisht punën e papaguar të kujdesit dhe efektet e saj ekonomike, duke vendosur një bazë ligjore për veprime politikash për ekonominë e kujdesit, pengesa kryesore strukturore që i pengon gratë me përgjegjësi kujdesi të krijojnë dhe të mbajnë biznese. Së treti, përputhshmëria e tij me Direktivën 2006/54/KE dhe Konventën e Stambollit forcon përputhshmërinë e Shqipërisë me Kapitujt 19 dhe 23 të legjislacionit të BE-së, të cilat Komisioni Europian i kishte identifikuar vazhdimisht si të tilla që kërkonin përputhshmëri të mëtejshme (Komisioni Europian, 2024; Komisioni Europian, 2025; Eurochild, 2025). Buxhetimi i përgjigjshëm gjinor është zgjeruar ndjeshëm: investimet publike të përcaktuara për barazinë gjinore u rritën nga 90 milionë USD në 9 programe buxhetore në ciklin 2017–2019 në mbi 803 milionë USD në 77 programe deri në vitin 2025, me objektiva specifike gjinore të integruara tani në 59% të programeve buxhetore për vitin 2025 (UN Women Albania, 2025a; Kombet e Bashkuara në Shqipëri, 2024). Ky zgjerim buxhetor siguron, në parim, hapësirën fiskale për masa të përgjigjshme gjinore në ndërmarrje, por shkalla në të cilën ky buxhet shkon tek gratë sipërmarrëse, përfshirë ato të margjinalizuara, varet nga përgjegjshmëria gjinore për hartimin e programit specifik.

Një zhvillim i ndërlidhur legjislativ, i cili është i rëndësishëm për dimensionin ekonomik të dhunës me bazë gjinore, është miratimi i Ligjit nr. 11/2026[8] "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje", i miratuar në janar 2026. Mbështetja për punësim, sipërmarrje dhe riintegrim më të gjerë socio-ekonomik mund të plotësojë masat mbrojtëse të parashikuara në ligjin e ri[9].

Në nivel strategjik, Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021–2030 (SKBGJ 2021–2030), e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave dhe e botuar në Fletoren Zyrtare nr. 112, datë 15 korrik 2021, përbën kuadrin gjithëpërfshirës të politikave të barazisë gjinore (Qeveria e Shqipërisë, 2021b). Qëllimi Strategjik 1 i kushtohet fuqizimit ekonomik të grave dhe burrave, duke përfshirë objektivat mbi pjesëmarrjen në fuqinë punëtore, aksesin në kredi bankare, promovimin e sipërmarrjes së grave, uljen e hendekut gjinor të pagave (i raportuar në 4,9% në vitin 2024) dhe uljen e barrës së kujdesit të papaguar (INSTAT, 2025a). SKBGJ 2021–2030 u hartua në përputhje të qartë me Planin e Veprimit III të BE-së për Barazinë Gjinore (EU GAP III) 2021–2025 dhe synon harmonizimin progresiv me legjislacionin e BE-së për barazinë gjinore. Raporti i Komisionit Europian i vitit 2025 për Shqipërinë vlerësoi se ligji i ri "Për barazinë gjinore" ruan një nivel të lartë ambicieje për përputhje me standardet e BE-së, duke riafirmuar njëkohësisht se zbatimi i efektshëm, bashkërendimi institucional dhe efekti i matshëm mbeten sfidat kryesore (Komisioni Europian, 2025).

8. Ligji Nr. 11/2026, datë 28 Janar 2026, "Për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje", Qendra e Botimeve Zyrtare, Republic of Albania.
9. Raporti i Pestë Periodik i paraqitur në përputhje me nenin 18 të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave, CEDAW/C/ALB/5, 25 shkurt 2022.

Aktualisht, Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka filluar procesin e konsultimit me ekspertë për miratimin e Planit të Veprimit për Barazinë, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2026-2030 në Republikën e Shqipërisë, me mbështetjen e Programit të BE-së dhe Këshillit të Europës në Shqipëri, Integrimi i Romëve III.

Plani i veprimit identifikon punësimin dhe aftësitë si një nga shtyllat prioritare dhe përfshin masa për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në programet aktive të punësimit, formimit profesional dhe rrugët formale të punësimit. Megjithatë, ai nuk përmban masa specifike për gratë sipërmarrëse rome ose egjiptiane dhe nuk artikulon një strategji punësimi dhe sipërmarrjeje të diferencuar gjinore për gratë e këtyre komuniteteve.

Hendeku më i rëndësishëm strukturor në të gjithë kuadrin e barazisë gjinore, sa i përket rëndësisë së tij të drejtpërdrejtë për këtë dokument politikash, është nevoja për një Plan të ri Kombëtar Veprimi për Sipërmarrjen e Grave përtej vitit 2020. Ky plan, që mbulon periudhën 2014–2020 dhe është hartuar me asistencën teknike të UN Women, ishte i vetmi instrument i ndërtuar me një qëllim të veçantë dhe i kufizuar në kohë në historinë e politikave shqiptare, i fokusuar posaçërisht në sipërmarrjen e grave (UN Women Europe and Central Asia, pa datë; GADC, 2023).

Përfundimi i vlefshmërisë së tij pa u zëvendësuar nga një instrument tjetër e ka lënë sipërmarrjen e grave pa një kuadër të dedikuar qeverisjeje dhe llogaridhënieje në një kohë ndryshimesh të rëndësishme ekonomike, ambicieve të zgjeruara për anëtarësim në BE dhe të dhënave në rritje për shkallën dhe thellësinë strukturore të pengesave me të cilat përballen gratë që kërkojnë të fillojnë, regjistrojnë dhe rrisin bizneset në Shqipëri. "Profili i barazisë gjinore i vendit" i UN Women Albania, i botuar në dhjetor 2025, identifikoi si një nga rekomandimet e tij thelbësore nevojën për të investuar në kontributet aktive të grave në ekonomi (përfshirë edhe përmes mbështetjes së synuar të ndërmarrjeve) si pjesë e një pakete veprimesh të nevojshme për të mbyllur boshllëqet në zbatimin e legjislacionit për barazinë gjinore (UN Women Albania, 2025b). Ky rekomandim përforcon drejtpërdrejt nevojën për masat e propozuara në këtë dokument politikash.

SIPËRMARRJA E GRAVE NË SHQIPËRI

5.SIPËRMARRJA E GRAVE NË SHQIPËRI

5.1 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I BAZËS SË TË DHËNAVE

Bazuar në të dhënat e "Regjistrave të Biznesit" të publikuara nga INSTAT 2022-2024 (për vitet e veprimtarisë 2021-2024), tabela e mëposhtme sugjeron se sipërmarrja e grave në Shqipëri nxitet kryesisht nga veprimtaria e sipërmarrjeve të vogla, veçanërisht në sektorët e orientuar drejt shërbimeve, siç janë tregtia, shërbimet e tjera dhe akomodimi/ushqimi.

Ky model mund të tregojë hyrje më të lehtë në veprimtari shërbimesh në shkallë të ulët, por gjithashtu mund të pasqyrojë pengesa të vazhdueshme për rritjen e biznesit, financimin, formalizimin, pronësinë e pronës dhe hyrjen në sektorë të mbizotëruar nga burrat, siç janë ndërtimi, transporti dhe pjesë të industrisë.

TABELA 1.
Sipërmarrje në pronësi të grave me 1-4 punonjës/e

Viti	Sipërmarrje gjithsej në pronësi të grave	Sipërmarrje në pronësi të grave me 1-4 punonjës/e	Përqindja e grave brenda grupit me 1-4 punonjës/e	Përqindja e sipërmarrjeve në pronësi të grave që kanë 1-4 punonjës/e
2021	36,917	32,942	32.4%	89.2%
2022	39,074	34,816	32.5%	89.1%
2023	40,605	36,248	32.4%	89.3%
2024	41,512	36,954	32.6%	89.0%

Burimi: Puna e autores mbështetur në të dhënat e INSTAT-it

Të dhënat tregojnë shumë qartë se gratë sipërmarrëse në Shqipëri janë të përqendruara në mënyrë dërrmuese në biznese shumë të vogla. Gjatë të katër viteve, rreth 89% e të gjitha sipërmarrjeve në pronësi të grave janë pjesë e kategorisë me 1-4 punonjës/e. Shpërndarja sipas sektorëve tregon se sipërmarrjet në pronësi të grave në Shqipëri janë të përqendruara në mënyrë dërrmuese në shërbime dhe tregti të tjera, me një nivel të dytë në veprimtaritë e akomodimit dhe shërbimit ushqimor (Figura 1).

Prania e grave mbetet e kufizuar në industri, teknologji informacioni dhe komunikimi, ndërtim, transport dhe qendra grumbullimi dhe bujqësi, duke treguar një përqendrim të ngushtë të sipërmarrjes së grave në veprimtaritë e orientuara drejt shërbimeve.

Shpërndarja sipas sektorëve e ndërmarrjeve aktive tregon një model të qartë gjinor në pronësinë e biznesit në Shqipëri. Ndërmarrjet në pronësi të grave janë të përqendruara kryesisht në tregti dhe shërbime të tjera, me një prani më të vogël, por ende të dukshme në veprimtaritë e akomodimit dhe shërbimit ushqimor. Nga ana tjetër, gratë mbeten dukshëm të nënpërfaqësuara në sektorë që shpesh shoqërohen më fort me intensitet më të lartë kapitali, potencial më të madh produktiviteti, lidhje infrastrukturore dhe mundësi më të forta afatgjata zgjerimi, përfshirë sektorë si ndërtimi, transporti dhe qendra grumbullimi, industria dhe pjesë të bujqësisë (Figura 1, Figura 2).

FIGURA 1.

Ndërmarrjet në pronësi të grave sipas sektorëve të biznesit në Shqipëri, 2024



Burimi: Analiza e autores mbështetur tek INSTAT, Regjistrat e Biznesit 2024, tabela "Ndërmarrjet aktive sipas veprimtarisë ekonomike dhe gjinisë së pronarit/administratorit".

Ky model është strategjikisht i rëndësishëm për politikat. Ai sugjeron që sipërmarrja e grave nuk është vetëm më e vogël nëmadhësi, por edhe më e përqendruar në sektorë me pengesa më të ulëta fillimi dhe, shpesh, perspektiva më të voglarritjeje. Burrat vazhdojnë të mbizotërojnë pronësinë në disa sektorë ekonomikisht të rëndësishëm që janë thelbësorë për transformimin strukturor, shtimin e vlerës, logjistikën, përmirësimin industrial dhe pjesëmarrjen në tregje më të mëdha. Në terma praktikë, kjo do të thotë që gratë janë më pak të pranishme në sektorët që mund të sjellin zgjerim më të madh të biznesit, grumbullimin e pasurisë dhe krijimin e punësimit formal.

Prandaj, të dhënat tregojnë një sfidë të dyfishtë. Së pari, gratë kanë nevojë për mbështetje të vazhdueshme për të forcuar dhe formalizuar praninë e tyre në veprimtaritë e shërbimit ku ato janë tashmë aktive. Së dyti, dhe në mënyrë më strategjike, masat e politikave duhet të trajtojnë pengesat strukturore që kufizojnë hyrjen e grave

në sektorë të mbizotëruar nga burrat me potencial më të madh rritjeje dhe prodhimi. Këto pengesa mund të përfshijnë akses të pabarabartë në financim dhe kolateral, ndarje të profesioneve sipas gjinisë, akses të kufizuar në rrjetet e biznesit dhe informacionin e tregut, pjesëmarrje më të ulët në punët teknike dhe profesionale, pabarazi në përgjegjësitë e kujdesit dhe norma sociale të vazhdueshme në lidhje me sektorët "e përshtatshëm" për gratë.

FIGURA 2.

Ndërmarrjet në pronësi të grave sipas sektorëve të biznesit në Shqipëri, 2021–2024



Burimi: Analiza e autores mbështetur tek INSTAT, Regjistrat e Biznesit 2021, 2022, 2023, 2024, tabela "Sipërmarrjet aktive sipas veprimtarisë ekonomike dhe gjinisë së pronarit/administratorit".

Implikimi kryesor është se avancimi i sipërmarrjes së grave në Shqipëri nuk duhet të kuptohet vetëm si rritje e numrit të bizneseve në pronësi të grave. Ai gjithashtu kërkon përmirësimin e pozicionimit të grave sipërmarrëse në sektorë të ndryshëm. Një qasje më transformuese do të synonte të mbështeste gratë jo vetëm për të filluar biznese, por edhe për të hyrë, për të mbijetuar dhe për t'u rritur në sektorë strategjikë ku ato aktualisht janë të nënpërfaqësuara. Kjo është thelbësore për zhvillim ekonomik gjithëpërfshirës, qëndrueshmëri më të fortë dhe pjesëmarrje më të barabartë në ekonominë prodhuese të vendit.

Përqendrimi i grave në sektorë me rritje të ulët dhe me pak barriera hyrëse nuk është i dukshëm vetëm tek bizneset në pronësi të grave, ai pasqyron gjithashtu pozicionin më të gjerë të grave në tregun e punës. Për shumë gra, vetëpunësimi nuk është një rrugë e zgjedhur lirisht drejt rritjes së biznesit, por një përgjigje ndaj mundësive të kufizuara për punësim.

Gratë me nivel të ulët arsimimi formal ose të paarsimuara përballen me një shkallë përjashtimi të vlerësuar në 42%, duke konfirmuar se disavantazhi në arsimim është ndër elementët më të fortë individualë të përjashtimit nga tregu i punës dhe sipërmarrja (Figura 3). Gratë në zonat rurale dhe gratë që mbajnë përgjegjësi të papaguara kujdesi, shumica e të cilave janë jashtë punësimit formal pikërisht për shkak të mungesës së shërbimeve të kujdesit, përballen me një shkallë përjashtimi në masën 36% dhe 55% përkatësisht. Gratë egjiptiane në moshë pune përballen me shkallë papunësie prej afërsisht 55% sipas të dhënave të PNUD-it, të nxitura nga pengesat komplekse të diskriminimit etnik, varfërisë dhe aksesit të

FIGURA 3.

Shkalla e përjashtimit nga punësimi sipas grupeve të pafavorizuara, gratë shqiptare, 2022–2023



Burimi: Puna e autores mbështetet mbi të dhënat e INSTAT-it, Anketa e Forcave të Punës 2022–2023 (NEET kombëtare e grave); TZHB-të e Bankës Botërore (SHPFP-ja për gratë); Eurostat 2022.

kufizuar në institucione. Gratë rome të moshës 18 deri në 24 vjeç regjistrojnë shkallën më të lartë të përjashtimit në të dhënat me 90%, si rezultat i martesave të hershme, braktisjes së shkollës, diskriminimit në tregun e punës dhe kufizimeve, mundësisë në regjistrimin formal dhe në sistemet e kredive bankare.

Të marra së bashku, figura tregon se përjashtimi nga punësimi në Shqipëri nuk është i shpërndarë në mënyrë të njëtrajtshme: ai përqendrohet në kombinimin e gjinisë me etninë, gjeografinë, arsimin dhe përgjegjësitë e kujdesit. Ky model ka efekte të drejtpërdrejta në politikën për sipërmarrjen, pasi gratë që janë të përjashtuara nga punësimi formal janë gjithashtu, nga të njëjtat mekanizma strukturorë, të përjashtuara nga ekosistemi i mbështetjes së sipërmarrjes. Politikat që janë hartuar për gratë sipërmarrëse mesatare nuk do të mund të arrijnë tek ato gra që përballen me pengesat më të mëdha dhe që do të përfitonin më shumë nga lehtësimi i synuar.

Një dimension specifik i cenueshmërisë së punësimit me ndikime të drejtpërdrejta për sipërmarrjen e grave ka të bëjë me sektorin e përpunimit të veshjeve, i referuar në vend si sektori fason. Sektori punëson afërsisht 87% gra, të shpërndara nëpër fabrika në Tiranë, Durrës, Fier, Elbasan, Korçë dhe Shkodër, me shumicën e punëtoreve që kanë vetëm arsim fillor ose të mesëm dhe marrin pagë minimale ose diku afër minimales (GADC, 2024). Sektori aktualisht po tkurret ndjeshëm: vlerat e eksportit të veshjeve ranë me 25% midis viteve 2023 dhe mesit të vitit 2025, forcat e punës ranë me gati një të pestën krahasuar me vitin 2023, dhe mbi 70 fabrika të nivelit të mesëm u mbyllën gjatë viteve 2024–2025, të nxitura nga mbivlerësimi i lekut, rritja e kostove të pagave dhe dobësimi i kërkesës europiane (INSTAT, siç citohet në Monitor.al, 2025).

Për politikën e sipërmarrjes së grave, këto kanë rëndësi sepse punonjëset në fasoneri, me nivel të ulët arsimor, gjeografikisht periferikë, me kursime minimale dhe përgjegjësi të mëdha kujdesi, ndajnë pikërisht profilin strukturor që kufizon më shumë fillimin dhe rritjen e biznesit midis grave sipërmarrëse të shqyrtuara në këtë dokument, duke e bërë tkurrjen e sektorit një kanal të drejtpërdrejtë që çon në punë informale të pasigurt dhe në përjashtimin e dokumentuar në të gjithë këtë seksion.

Parimet e Fuqizimit të Grave (PEG/WEPs) janë një kuadër i njohur globalisht që ofron udhëzime praktike për bizneset për avancimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave në vendin e punës, në treg dhe komunitet më të gjerë. Në kontekstin shqiptar, niveli i përvetësimit mbetet i kufizuar. Që nga fundi i marsit 2026, vetëm 87 shoqëri në Shqipëri kanë nënshkruar ose lëshuar publikisht një deklaratë mbështetëse për Parimet e Fuqizimit të Grave. Kjo sugjeron që, teksa kuadri është i disponueshëm dhe i njohur ndërkombëtarisht, zbatimi i tij brenda sektorit privat kombëtar është ende modest. Krahas rritjes së numrit të bizneseve në pronësi të grave, është organizuar një nismë në nivel rajonal e kombëtar (EXPO e Sipërmarrjes së Grave 2022-2023-2024-2025), si një platformë për promovimin e sipërmarrjeve të grave. Në këtë nismë të zbatuar nga UN Women me partnerë të ndryshëm, janë angazhuar shoqëri të mëdha që mbështesin PFG-të (WEPs), biznese të drejtuara nga gratë, institucione publike dhe partnerë ndërkombëtarë që synojnë të diskutojnë mekanizmat e financimit dhe zhvillimin e modeleve më gjithëpërfshirëse të biznesit. Platforma të tilla kanë mbështetur 40 deri në 80 gra sipërmarrëse nga Shqipëria çdo vit, në forcimin e aksesit të tyre në rrjetet e investitorëve dhe bizneseve, duke kontribuar kësisoj në një rritje ekonomike më gjithëpërfshirëse gjinore.

PENGESAT STRUKTURORE QË NDIKOJNË NË SIPËRMARRJEN E GRAVE NË SHQIPËRI

6. PENGESAT STRUKTURORE QË NDIKOJNË NË SIPËRMARRJEN E GRAVE NË SHQIPËRI

6.1 GJETJET NGA TRYEZA E RRUMBULLAKËT E KONSULTIMIT ME PALËT E INTERESUARA

Konsultimi me palët e interesuara dhe përvoja që doli nga "EXPO për sipërmarrjen e grave 2025" konfirmon se gratë sipërmarrëse në Shqipëri përballen me një sërë pengesash strukturore që përforcojnë njëra-tjetrën dhe jo me vështirësi të izoluara. Këto pengesa ndikojnë në fillimin, mbijetesën, formalizimin dhe rritjen e biznesit, dhe janë veçanërisht kufizuese për gratë që drejtojnë ndërmarrje mikro dhe të vogla, si dhe për gratë në situata të pafavorshme dhe të margjinalizuara. Më poshtë janë përmbledhur gjetjet e panelistëve dhe pjesëmarrës/eve mbi sfidat dhe pengesat.

AKSESI NË FINANCIM

Pjesëmarrësi/et theksuan vazhdimisht se gratë shpesh përballen me vështirësi në sigurimin e kapitalit fillestar, fuqisë punëtore, garancive dhe kredive të përballueshme. Ky kufizim është veçanërisht i theksuar për gratë me kolateral të kufizuar, histori të të ardhurave të parregullta, veprimtari ekonomike informale ose akses të dobët në informacionin financiar. Për shumë gra sipërmarrëse, sistemi i financimit nuk funksionon si një mekanizëm mundësues, nxitës, por si një filtër që përjashton ato që nuk zotërojnë tashmë pasuri, rrjete ose besueshmëri financiare. Kjo e bën financimin jo vetëm një çështje tregu, por edhe një çështje përfshirjeje strukturore.

Përputhja e kufizuar midis programeve ekzistuese të mbështetjes dhe realitetit të sipërmarrjeve mikro/të vogla të drejtuara nga gratë. Pjesëmarrësi/et në konsultim theksuan se shumë skema mbështetjeje janë hartuar rreth modeleve standarde të biznesit, trajektoreve formale të rritjes ose sipërmarrjeve të orientuara drejt inovacionit, ndërsa shumë gra operojnë në veprimtari tradicionale, me bazë në shtëpi, aktivitete artizanale, të shërbimit ose me kapital të ulët. Si rezultat, mbështetja formalisht e disponueshme nuk përkthehet gjithmonë në mbështetje të arritshme. Kjo mospërputhje institucionale është veçanërisht e rëndësishme sepse do të thotë që përjashtimi mund të vazhdojë edhe aty ku programet ekzistojnë zyrtarisht.

Dobësia e strukturave të rrjetëzimit, informacionit dhe marketingut të biznesit. Gratë sipërmarrëse raportuan akses më të dobët në forume profesionale, shkëmbime mes kolegë/eve, partneritete dhe inteligjencë tregu. Kjo zvogëlon aftësinë e tyre për të identifikuar klientë/et, furnizuesi/et, mentorë/et, mundësitë e financimit dhe bashkëpunimet strategjike. Dobësia e strukturave të rrjetëzimit nuk është një çështje dytësore: për bizneset e vogla, rritja e tregut shpesh varet po aq shumë nga qasja në marrëdhënie sa edhe nga aksesi në kapital.

Mangësitë në shprehi dhe aftësi, veçanërisht në digjitalizim, marketing dhe zhvillim të biznesit. Pjesëmarrësi/et theksuan se gratë shpesh kanë nevojë për më shumë mbështetje praktike në shitjet online, menaxhimin financiar, krijimin e markës, pozicionimin në treg dhe përdorimin e mjeteve digjitale. Kjo nuk pasqyron mungesë interesi ose mungesë të potencialit sipërmarrës. Përkundrazi, kjo pasqyron akses të pabarabartë në shërbime mbështetëse të synuara, me cilësi të lartë dhe të përballueshme, të cilat të jenë përshtatur me oraret, vendndodhjet dhe realitetet e biznesit të grave.

Kompleksiteti institucional dhe asimetria e informacionit. Gratë sipërmarrëse raportuan se informacioni mbi tatimet, licencimin, formalizimin, mundësitë për grante dhe mbi programet e mbështetjes publike është shpesh i fragmentuar, i paqartë ose i vështirë për t'u përdorur.

Për gratë me kohë të kufizuar, me aftësi më të pakta digjitale ose me përvojë të kufizuar me procedurat zyrtare të biznesit, kjo krijon një barrë të fshehur të pajtueshmërisë. Në praktikë, vetë kompleksiteti bëhet një pengesë për zyrtarizimin dhe rritjen, zhvillimin.

Konsultimi gjithashtu tregoi disa përgjigje konkrete. Pjesëmarrësi/et propozuan rregullime ligjore dhe fiskale për gratë artizane dhe prodhuese me kohë të pjesshme, procedura të thjeshtuara për formalizimin, qendra vendore të sipërmarrjes, mentorim të synuar, mbështetje më të fortë për aftësitë digjitale dhe instrumente financimi të hartuara posaçërisht për bizneset e drejtuara nga gratë, përfshirë skemat e garancisë dhe mikrokredive më të arritshme. Propozimet janë të rëndësishme sepse tregojnë se pengesat e identifikuara nuk janë thjesht diagnostikuese. Ato gjithashtu sugjerojnë rrugë realiste për përgjigje dhe reagim institucional.

6.2 GJETJET NGA PYETËSORI I SHPËRNDARË GRAVE

SHËNIM METODOLOGJIK

Një pyetësor i strukturuar iu shpërnda grave të përfshira në sipërmarrje mikro dhe të vogla në të gjithë Shqipërinë. Të anketuarat u kontaktuan përmes rrjeteve të projekteve të zbatuara më parë në hapësirën e sipërmarrjes së grave, duke siguruar shpërndarje gjeografike nëpër rajone të ndryshme të vendit në vend të përqendrimit në një qendër të vetme urbane. Anketa mori përgjigje të plota.

Duke pasur parasysh këtë madhësi të kampionit, gjetjet e paraqitura në këtë seksion nuk janë statistikisht përfaqësuese të grave sipërmarrëse shqiptare si popullsi dhe nuk duhet të lexohen si të tilla. Kampioni është shumë i vogël për të mbështetur përgjithësimin. Vlera e anketës qëndron diku tjetër: ajo ofron të dhëna të drejtpërdrejta, në vetën e parë nga gratë që drejtojnë në mënyrë aktive sipërmarrje mikro dhe të vogla, dhe modelet që dalin në përgjigje janë të qëndrueshme nga brenda dhe të përafruara fort me gjetjet nga shqyrtimi i dokumenteve dhe tryeza e rrumbullakët e konsultimit me palët e interesuara e datës 24 prill. Prandaj, gjetjet e anketës trajtohen në të gjithë këtë seksion si ilustruese dhe cilësore në natyrë, një sinjal koherent nga një grup specifik i grave sipërmarrëse. Kur jepen përqindjet, ato përshkruajnë shpërndarjen brenda këtij grupi prej 64 të anketuarash, dhe nuk përfaqësojnë një pjesë të projektuar të popullatës më të gjerë të biznesit. Të marra së bashku, përgjigjet tregojnë katër grupe pengesash të ndërlidhura: përjashtimi financiar, barra e kujdesit, kufizimet e aksesit në treg dhe pamjaftueshmëria e perceptuar institucionale, të cilat së bashku ndihmojnë në shpjegimin pse sipërmarrjet e grave në këtë grup mbeten të përqendruara në nivelin mikro dhe përballen me vështirësi të vazhdueshme për t'u rritur.

Modeli më i spikatur ka të bëjë me aksesin në financim. Kur u pyetën për arsyen kryesore pse biznesi i tyre ka mbetur i vogël, 65% e të anketuarave identifikuan mungesën e financimit si kufizimin mbizotërues, i cili është një normë afërsisht tre herë më e lartë se faktori tjetër më i përmendur, mungesa e klientëve/aksesit në treg. Bizneset nuk po qëndrojnë të vogla sepse pronareve u mungojnë aftësitë ose kanë frikë nga rritja: ato qëndrojnë të vogla sepse nuk mund të kenë akses në kapital dhe përballen me një treg të vështirë.

FIGURA 4.

Arsyet përse biznesi juaj mbetet i vogël



Burimi: Komente nga gratë e anketuara gjatë anketës së zhvilluar në prill 2026.

Kjo gjetje është në përputhje me anketat e tjera dhe me gjetjet e "EXPO 2025", dhe përsëritja e saj në burimet e pavarura të të dhënave forcon besueshmërinë e saj, pavarësisht kampionit të vogël. Modeli i financimit të biznesit në fillimin e tij e mbështet më tej këtë pamje: shumica e të anketuarave e filluan sipërmarrjen duke përdorur kursimet personale (46,9%) ose me mbështetjen e familjes (32,8%), ndërsa kredia bankare luajti një rol të vogël në fazën fillestare në mesin e këtij grupi me 4,7% (pjesa e mbetur kishte mbështetje përmes granteve ose huave nga miqtë). Në aplikimet për kredi, 43,5% raportuan se nuk kishin aplikuar kurrë sepse nuk dëshironin të merrnin borxh, një përgjigje që, brenda këtij grupi, pasqyron më shumë shmangien racionale të rrezikut në kontekstin e normave të larta të interesit, kërkesave për kolateral dhe probabilitetit të perceptuar të refuzimit sesa mungesën e ndërgjegjësimit financiar. 24,2% e të anketuarave të tjera nuk aplikuan sepse nuk plotësonin kushtet, dhe 8% aplikuan, por u refuzuan. Në përgjithësi, 77,8% e grave të anketuara raportuan se ishte shumë e vështirë (50,8%) ose e vështirë (27,8%) të merrnin financim për të filluar biznesin e tyre. Ndërsa këto shifra nuk mund të ekstrapolohen në popullatën më të gjerë, ato janë në përputhje me përjashtimin strukturor të financimit të dokumentuar në bazën më të gjerë të të dhënave dhe i shtojnë analizën cilësore asaj tabloje.

Modeli i dytë i spikatur është barra e kujdesit të papaguar. Përgjegjësitë familjare peshojnë shumë në rritjen e biznesit të grave: 62,5% e tyre raportojnë një ndikim të fortë (të konsiderueshëm ose shumë). Vetëm 7,8% e të anketuarave thonë se përgjegjësitë familjare kanë pak ose aspak efekt në biznesin e tyre (Figura 5).

FIGURA 5.

Sa ndikojnë përgjegjësitë familjare dhe ngarkesa e punëve shtëpiake në biznesin tuaj?



Burimi: Komente nga gratë e anketuara gjatë anketës së zhvilluar në prill 2026

Kjo gjetje është në përputhje me të dhënat kombëtare që tregojnë se gratë shqiptare kryejnë shumicën e punës së papaguar të kujdesit, dhe me shifrat e fuqisë punëtore që tregojnë se 14,0%e grave joaktive përmendin punët shtëpiake si arsyen e mungesës së aktivitetit, krahasuar me 0.4% të burrave. Për gratë që drejtojnë biznese të vogla, kufizimet nga kujdesi përkthehen drejtpërdrejt në më pak kohë në dispozicion për biznesin, kapacitet të reduktuar për të ndjekur trajnime ose për të ndërtuar rrjete profesionale, dhe elasticitet më të ulët për të zgjeruar operacionet ose për të ndjekur mundësi për rritje. Fakti që pothuajse asnjë e anketuar nuk përmendi mbështetjen për kujdesin ndaj fëmijëve si një nevojë specifike nuk ka gjasa të tregojë se kujdesi nuk është problem.

Ka shumë të ngjarë që brenda këtij grupi, përgjegjësitë e kujdesit trajtohen si një çështje private që duhet të menaxhohet individualisht dhe jo si një pengesë sistemike që duhet ta trajtojë politika.

Lidhur me përvojën specifike gjinore, përgjigjet brenda grupit janë konsistente: pothuajse 4 në 5 gra pronare biznesi (79,7%) raportojnë se përballen me më shumë pengesa në biznes për shkak të gjinisë së tyre. Vetëm 15,6% e grave të anketuara konsiderojnë përvojën e tyre të barasvlershme me atë të burrave, dhe në mënyrë të dukshme asnjë e anketuar nuk zgjodhi alternativën “aspak”. 4.7% e tyre nuk ishin të sigurta.

FIGURA 6.

Figura 6: A hasni më shumë pengesa në biznes sesa burrat?



Burimi: Komente nga gratë e anketuara gjatë anketës së zhvilluar në prill 2026

Përgjigjet cilësore ndaj pyetjes së hapur mbi pengesën më të madhe për rritjen e biznesit të vogël, gratë përmendën mangësitë në mbështetjen financiare, paragjykimet shoqërore, mungesën e besimit dhe vetëbesimit, mungesën e rrjeteve profesionale dhe vështirësinë për balancimin e përgjegjësive të kujdesit me kërkesat e biznesit. Këto përgjigje janë të përbashkëta në të gjithë grupin dhe përforcojnë pamjen strukturore të gjetur në shqyrtimin e dokumenteve dhe gjatë konsultimit.

Modeli tjetër ka të bëjë me aksesin në treg dhe mbështetjen e aftësive. Brenda këtij grupi, marketingu dhe gjetja e klientëve të rinj dolën si nevoja më e përmendur për mbështetje me 54,5%, e ndjekur nga rrjetëzimi i biznesit (27,3%), aksesi më i lehtë në financim (24,2%), procedura më të thjeshtuara tatimore (24,2%) dhe mbështetja e digjitalizimit (21,2%). Aspirata dhe kapaciteti për rritje janë të pranishme brenda këtij grupi të të anketuarave. Ajo që ilustron anketa (në përputhje me bazën më të gjerë të të dhënave) është se pengesat strukturore të përqendruara në financime, kujdes dhe akses në treg janë pengesat kryesore që pengojnë realizimin e këtij potenciali.

PËRFUNDIME DHE PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE

7. PËRFUNDIME DHE PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE

Analiza në këtë dokument të politikave tregon se sipërmarrja e grave në Shqipëri po rritet në drejtim të marketingut, por mbetet e kufizuar strukturalisht në aspektin e madhësisë, pozicionimit në sektorë dhe potencialit të rritjes. Gratë janë qartësisht të pranishme në veprimtarinë e biznesit, megjithatë ato mbeten të nënpërfaqësuara në pronësi në përgjithësi dhe janë shumë të përqendruara në ndërmarrjet e vogla dhe në sektorët e shërbimeve me pengesa hyrëse relativisht të ulëta dhe shpesh perspektiva më të ulëta rritjeje. Kjo do të thotë se sfida nuk është vetëm ajo e pjesëmarrjes, por edhe ajo e cilësisë së biznesit, qëndrueshmërisë dhe pranisë në segmente më produktive të ekonomisë.

- **Një gjetje qendrore është se sipërmarrja e grave në Shqipëri mbetet kryesisht sipërmarrje e ndërmarrjeve mikro/të vogla.** Rreth 89% e ndërmarrjeve në pronësi të grave bëjnë pjesë në kategorinë me 1-4 punonjës/e. Kjo nuk është një karakteristikë e kufizuare peizazhit të biznesit; është forma e saj mbizotëruese. Prandaj, politika duhet të hartohet rreth strukturës aktuale të sipërmarrjes së grave, jo rreth një modeli abstrakt të NVM-ve që i përshtatet vetëm një pakice rastesh.

- **Sipërmarrja e grave është shumë e përqendruar në sektorë të caktuar.** Gratë janë shumë më të pranishme në tregti, shërbime dhe veprimtari akomodimi dhe ushqimi, ndërsa mbeten të nënpërfaqësuara në sektorë të tillë si ndërtimi, transporti, industria dhe fusha të tjera të shoqëruara me produktivitet më të lartë, shtim vlere dhe potencial zgjerimi. Kjo tregon se politika e sipërmarrjes së grave nuk duhet të përqendrohet vetëm në rritjen e numrit të bizneseve, por edhe në përmirësimin e aksesit të grave në sektorë me potencial më të lartë zhvillimi.

- **Pengesat kryesore janë strukturore, jo individuale.** Të dhënat nga anketa, konsultimi dhe shqyrtimi i dokumenteve konvergojnë në një përfundim të përbashkët: përjashtimi financiar, barra e kujdesit, rrjetëzimi i kufizuar, aksesi i dobët në treg dhe kompleksiteti institucional janë pengesat kryesore që pengojnë rritjen e sipërmarrjeve të drejtuara nga gratë. Këto nuk janë pengesa që mund të kapërcehen vetëm përmes motivimit; ato kërkojnë korrigjim institucional.

- **Pengesat janë të ndërthurura dhe të shpërndara në mënyrë të pabarabartë.** Gratë nuk preken në të njëjtën mënyrë. Gratë në zonat rurale, gratë rome dhe egjiptiane, gratë me nivele të ulëta arsimimi, gratë në punë informale, gratë me aftësi të kufizuara dhe gratë me përgjegjësi të mëdha kujdesi përballen me disavantazhe të ndërlikuara. Kjo do të thotë që masat e përgjithshme të sipërmarrjes, nëse nuk synohen posaçërisht, ka të ngjarë t'u sjellin përfitime më shumë grave sipërmarrëse më të dukshme dhe me lidhje më të shumta, duke lënë pas ato me kufizimet më të mëdha.

- **Ekziston një mospërputhje midis arkitekturës aktuale të mbështetjes dhe realiteteve të ndërmarrjeve mikro dhe të vogla të drejtuara nga gratë.** Institucionet dhe programet ekzistuese ofrojnë një bazë të rëndësishme, por ato ende nuk duken të përshtatura mjaftueshëm, të bazuara mjaftueshëm në të dhëna ose të synuara mjaftueshëm për të siguruar qasje të barabartë dhe rezultate të matshme për gratë,

veçanërisht ato nga grupet e pafavorizuara. Mungesa e të dhënave sistematike të përfitues/eve të ndara sipas gjinisë dobëson më tej llogaridhënien dhe e bën të vështirë vlerësimin e asaj që po funksionon në të vërtetë.

- **Kuadri aktual i politikave është më i fortë në angazhimin formal sesa në përkthimin e tij në veprimtari.** Shqipëria ka forcuar legjislacionin e saj për barazinë gjinore dhe kuadrin strategjik, dhe kjo krijon një hapje të rëndësishme për politika më gjithëpërfshirëse të sipërmarrjeve. Në të njëjtën kohë, mosrinovimi i një plani veprimi kombëtar të dedikuar për sipërmarrjen e grave pas vitit 2020 ka lënë një hendek në menaxhim. Sipërmarrja e grave njihet në parim, por ende nuk mbështetet përmes një kuadri zbatimi mjaftueshëm koherent, me afate kohore dhe të matshëm.

- **Kufizimet e ekonomisë së kujdesit duhet të trajtohen si pjesë e politikës së sipërmarrjes.** Të dhënat tregojnë qartë se kujdesi i papaguar nuk është një çështje private; ai ndikon drejtpërdrejt në kohën e biznesit të grave, lëvizshmërinë, pjesëmarrjen në trajnime dhe në mundësitë për rritje. Çdo strategji serioze për sipërmarrjen e grave në Shqipëri duhet të integrojë masa të përgjigjshme ndaj kujdesit, në vend që ta trajtojë kujdesin vetëm si një çështje të politikës sociale të shkëputur nga pjesëmarrja në jetën ekonomike.

- **Gratë sipërmarrëse demonstrojnë aspirata të qarta rritjeje pavarësisht kushteve të pafavorshme.** Shumë të anketuara shohin potencial të fortë rritjeje në bizneset e tyre dhe do t'i inkurajonin gratë e tjera të hyjnë në sipërmarrje. Ky është një përfundim i rëndësishëm pozitiv: problemi nuk është mungesa e gatishmërisë, ambicies ose iniciativës midis grave. Problemi është se mjedisi i favorshëm mbetet shumë i dobët, shumë i pabarabartë dhe shumë i pamjaftueshëm për ta kthyer atë potencial në rritje të qëndrueshme të biznesit.

- **Roli i bashkive dhe strukturave vendore duhet të rritet me qëllim arritjen te gratë dhe ofrimin e shërbimeve më afër komunitetit.** Bashkitë mund të luajnë një rol më aktiv në udhëzimin, informimin dhe lidhjen e grave me shërbimet ekzistuese, si dhe në ndërtimin e urave të bashkëpunimit me institucione të tjera vendore, shkolla profesionale dhe aktorë të tjerë në ekonominë vendore (gjetje nga tryeza e rrumbullakët e datës 24 prill 2026).

- **Gratë në zonat rurale vijojnë të përballen me akses të kufizuar në financim, tregje dhe shërbime mbështetëse, ndërsa normat shoqërore dhe rolet tradicionale gjinore vazhdojnë të ndikojnë në vetëbesimin, vendimmarrjen dhe pjesëmarrjen e tyre në ekonomi.** Një nga çështjet më të theksuara është ndikimi i mendësisë dhe stereotipave shoqërorë. Normat shoqërore vazhdojnë të kufizojnë pjesëmarrjen aktive të grave në sipërmarrje, veçanërisht në zonat rurale, ku gratë shpesh përballen me pritshmëritë tradicionale në lidhje me rolin e tyre në familje dhe komunitet (gjetje nga tryeza e rrumbullakët e datës 24 prill 2026). Gratë në bujqësi kanë nevojë për një qasje të integruar që kombinon financimin, organizimin kolektiv, lidhjet me tregun, trajnimin praktik dhe masat që trajtojnë kufizimet sociale dhe familjare.

- **Një gjetje tjetër nga tryeza e rrumbullakët është nevoja që gratë sipërmarrëse të kenë një mbështetje më të qartë institucionale në fillim të biznesit.** Pjesëmarrësi/et theksuan se shumë gra, veçanërisht ato në fazën fillestare ose pa përvojë të mëparshme në biznes, nuk dinë se ku të kërkojnë këshilla, informacion ose shërbime konkrete. Kjo tregon nevojën për një sistem referimi më koherent, të dukshëm dhe miqësor për përdoruesit që mund t'i udhëzojë gratë sipërmarrëse në mënyrë më të efektshme përmes sistemit të mbështetjes së vazhdueshme.

Gratë artizane identifikojnë nevojën për më shumë mundësi për të marrë pjesë në panaire ndërkombëtare dhe për mbështetje më të madhe financiare që do t'u mundësonte artizaneve të prezantonin produktet e tyre në tregje më të gjera. Gjithashtu u konsiderua e vlefshme të krijohen nisma të lidhura me **"artizanet mjeshtre"** që synojnë transmetimin e aftësive artizanale te brezi i ri, si dhe hapjen e skemave të granteve për mentorim dhe për ruajtjen e vazhdimësisë së aftësive artizanale.

MESAZHI KRYESOR I POLITIKAVE

8. MESAZHI KRYESOR I POLITIKAVE

Mesazhi kryesor është se avancimi i sipërmarrjes së grave në Shqipëri nuk duhet të kuptohet vetëm si rritje e numrit të bizneseve në pronësi të grave. Ai gjithashtu kërkon përmirësimin e pozicionimit të grave sipërmarrëse në sektorë të ndryshëm.

Një qasje më transformuese do të synonte të mbështeste gratë jo vetëm për të filluar biznese, por edhe për të hyrë, për të mbijetuar dhe për t'u rritur në sektorë strategjikë ku ato aktualisht janë të nënpërfaqësuara. Kjo është thelbësore për zhvillimin ekonomik gjithëpërfshirës, qëndrueshmërinë më të fortë dhe pjesëmarrjen më të barabartë në ekonominë prodhuese të vendit.

Të dhënat në këtë dokument tregojnë një përfundim të qartë: Shqipëria duhet të kalojë nga angazhimet formale gjithëpërfshirëse të politikave në një model mbështetës të synuar, të përgjigjshëm gjinor dhe të matshëm për ndërmarrjet mikro dhe të vogla të drejtuara nga gratë, me vëmendje të veçantë për gratë e pafavorizuara dhe të margjinalizuara. Sfida kryesore nuk është mungesa e motivimit sipërmarrës të grave – të dhënat e anketës konfirmojnë aspiratat e forta dhe dëshirën për rritje - por vazhdimësia e pengesave strukturore në financime, kujdes, prani në treg dhe struktura institucionale.

Një rol më i qëndrueshëm i shtetit do të jetë thelbësor nëse barazia gjinore synon të bëhet një pjesë kuptimplote e zhvillimit të sektorit privat, dhe jo thjesht një çështje e veçuar politike. Ndërsa Shqipëria përparon në procesin e përafrimit me acquis-në e Bashkimit Evropian, krijohet një mundësi për të integruar në mënyrë më sistematike perspektivën gjinore në raportimin e bizneseve, dialogun publik-privat dhe hartimin e reformave për zhvillimin e sektorit privat.
Kjo është veçanërisht e rëndësishme në kuadër të drejtimit të politikave që lidhen me Kapitujt 23 dhe 24 të negociatave për anëtarësim në BE, si edhe me kuadrin më të gjerë të raportimit për qëndrueshmërinë e korporatave. Të dyja këto mund të kontribuojnë në shndërrimin e angazhimeve për barazinë gjinore në standarde më të qarta, mekanizma më të fortë llogaridhënieje dhe një zbatim më të qëndrueshëm.

Nëntë rekomandimet më poshtë janë të organizuara sipas përparësisë brenda secilit afat kohor. Veprimet afatshkurtra (0-12 muaj) janë kryesisht masa administrative ose qeverisëse që nuk kërkojnë buxhete të reja të mëdha. Veprimet afatmesme (1–3 vjet) kërkojnë hartimin e programit, bashkërendimin institucional ose përgatitjen e rregulloreve. Veprimet afatgjata (3+vjet) përfshijnë reformën rregullatore ose ndryshimin e infrastrukturës së sistemit. Së bashku ato përbëjnë një përgjigje koherente dhe të strukturuar ndaj pengesave të identifikuara në këtë dokument.

#	Rekomandimi	Institucioni (et) kryesor(e)	Partneritete dhe mbështetje	Afati kohor	Lidhja me kuadrin ekzistues
R1	**Hartimi dhe miratimi i një Plani të ri Kombëtar Veprimi për Sipërmarrjen e Grave (2026–2030),** me objektiva të përcaktuara në kohë, linja buxhetore të dedikuara dhe raportim vjetor të progresit. Kjo është përgjigjja e vetme më e drejtpërdrejtë institucionale ndaj hendekut qeverisës të krijuar nga mosrinovimi i planit 2014–2020.	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit; Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale	AIDA; AKPA-ja; organizatat e shoqërisë civile; UN Women; të tjera.	**Afatshkurtër** (miratuar deri në fund të vitit 2026)	SKBGJ 2021–2030, Objektivi 1; SKZHBI 2021–2027; Raporti i KE-së për Shqipërinë 2025, kriteret për mbylljen e Kapitullit 20
R2	**Mbledhjes e** të dhënave të ndara sipas gjinisë në të gjitha programet kryesore të mbështetjes së sipërmarrjes dhe NVM-ve, duke përfshirë grantet e AIDA-s, trajnimet e zhvilluara nga AKPA-ja dhe skemat e Agjencisë "Start-up Albania". Raportimi i përvitshëm mbi aplikantët, përfituesit, shkallën e miratimit, mbështetjen mesatare të marrë dhe rezultatet e biznesit sipas gjinisë.	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit	AIDA; AKPA-ja; Agjencia "Start-up Albania"; INSTAT-i	**Afatshkurtër** (udhëzimi administrativ brenda 12 muajve)	Ligji "Për barazinë gjinore" 2025; SKBGJ 2021–2030; Kapitulli 23 (detyrimet për barazinë gjinore) i legjislacionit të BE-së; kriteret e politikave të NVM-ve të Kapitullit 20
R3	**Krijimi i një linjeje financimi të dedikuar për sipërmarrjet mikro dhe të vogla të drejtuara nga gratë** brenda skemave ekzistuese publike dhe instrumenteve të bankave partnere, me kritere pranimi të thjeshtuara, shuma më të vogla financimi, mbështetje me garanci dhe shërbime këshillimi të lidhura me aksesin në financime.	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit; AIDA	Programi i BERZH-i "Gratë në biznes -Ballkani Perëndimor (EFSD+); bankat tregtare partnere; të tjerë.	**Afatmesëm** (funksional deri në vitin 2027)	SKZHBI 2021–2027; Ligji nr. 25/2022 për Start-up-et; Programi i BERZH-it EFSD+; Kapitulli 20 i legjislacionit të BE-së
R4	**Pilotimi i zyrave të shërbimit në bashki për sipërmarrjen e grave në tri bashki** (urbane, suburbane, rurale), duke ofruar mbështetje të integruar për regjistrimin, tatimet, formalizimin, orientimin financiar dhe mentorimin; vlerësimi dhe zgjerimi i mbështetur në rezultatet.	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit; Ministria e Shtetit për Pushtetin Vendor; Njësitë e Qeverisjes Vendore	Zyrat rajonale të AKPA-së; AIDA; programet e financuara nga BE-IPA; OSHC; UN Women Albania.	**Afatmesëm** (programe pilot deri në vitin 2027–2028)	SKZHBI 2021–2027; Rrjeti vendor i ofrimit të shërbimeve të AKPA-së; Programi "EU4Innovation" (2023–2026); Kapitulli 20 i legjislacionit të BE-së

#	Rekomandimi	Institucioni (et) kryesor(e)	Partneritete dhe mbështetje	Afati kohor	Lidhja me kuadrin ekzistues
R5	**Forcimi i rolit të platformave ekzistuese të sipërmarrjes së grave – përfshirë EXPO-n e Sipërmarrjes së Grave, Javën Globale të Sipërmarrjes dhe rrjetet lokale** të biznesit **- si ekosisteme të integruara për akses në treg dhe mbështetje për biznesin.** Të konsolidohen mekanizmat e lidhjes me furnitorët, ndërmjetësimit të partneriteteve të biznesit, krijimit të lidhjeve me investitorët dhe mentorimit të strukturuar pas aktiviteteve, në mënyrë që këto platforma të gjenerojnë mundësi të qëndrueshme biznesi dhe të mos shërbejnë kryesisht si aktivitete promovuese.	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit; AIDA; UN Women Albania	Shoqatat e biznesit; nënshkruesit e PFG-ve; partnerët e sektorit privat	**Afatshkurtër-afatmesëm** (nga viti 2026 e në vijim);	Kuadri i PFG-ve; Nisma Ekspozita e UN Women Albania; SKZHBI 2021–2027
R6	**Zhvillimi i instrumenteve me qëllim rikualifikimin dhe përmirësimin e aftësive për gratë e zhvendosura nga sektorët në rënie,** me urgjencë të veçantë për gratë e punësuara më parë në industrinë fason (përpunimi i veshjeve), për të lehtësuar kalimin në mundësi të reja ekonomike, duke përfshirë punësimin në sipërmarrjet e drejtuara nga gratë, sektorët në zhvillim dhe vetëpunësimin.	Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA)	Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit; ofruesit e formimit profesional; shoqatat e punëdhënësve	**Afatshkurtër-afatmesëm** (hartimi i programit deri në fund të vitit 2026; zbatimi duke filluar nga viti 2027)	Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive 2023–2030; Plani i Zbatimit të Garancisë Rinore; Kapitulli 19 i legjislacionit të BE-së
R7	**Integrimi i masave të përgjigjshme ndaj kujdesit në hartimin e mbështetjes për sipërmarrjen,** duke përfshirë planifikimin e shërbimeve të trajnimit dhe këshillimit për të akomoduar përgjegjësitë e kujdesit, ofrimin e lidhjes së kujdesit për fëmijët ose mbështetjes financiare për kujdesin brenda programeve të mbështetjes së ndërmarrjeve dhe dispozita të qarta për fleksibilitetin e kohës së kujdesit në qendrat vendore të sipërmarrjes së grave.	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale; Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit; AKPA	Bashkitë; Shërbimi Social Shtetëror; UN Women Albania; Të tjerë	Afatmesëm (duke filluar nga 2027)	Ligji për Barazinë Gjinore 2025 (njohja zyrtare e punës së papaguar të kujdesit); SKBGJ 2021–2030, Objektivi 1; Kapitulli 19 i legjislacionit të BE-së

#	Rekomandimi	Institucioni (et) kryesor(e)	Partneritete dhe mbështetje	Afati kohor	Lidhja me kuadrin ekzistues
R8	**Shqyrtimi dhe hartimi i marrëveshjeve më elastike të punësimit me kohë të pjesshme për ndërmarrjet mikro dhe të vogla,** duke përfshirë rregulla të përshtatura për kontributet e sigurimeve shoqërore, për të mundësuar zgjerimin gradual të biznesit dhe për të krijuar mundësi pune më të arritshme për gratë me përgjegjësi kujdesi. Ndërmarrja e modelimit të ndikimit fiskal para propozimit legjislativ.	Ministria e Financave; Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit;	Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale; organet përfaqësuese të punëdhënësve dhe punëmarrësve; ONP; Të tjerë	**Afatgjatë** (modelimi fiskal 2026–2027; procesi legjislativ 2028 e në vijim)	SKZHBI 2021–2027; Ligji "Për barazinë gjinore" 2025; Kapitulli 19 i legjislacionit të BE-së (punësimi dhe politika sociale)
R9	**Trajtimi i përqendrimit sektorial duke mbështetur hyrjen e grave në sektorë me rritje më të madhe** (ndërtim, transport, industri, TIK) përmes kritereve të pranueshmërisë për grante të diferencuara sipas gjinisë, mentorimit të synuar në sektorët e mbizotëruar nga burrat dhe promovimit të rrugëve teknike dhe profesionale për gratë në përputhje me Strategjinë e Specializimit Inteligjent (S3).	AIDA; Agjencia "Start-up Albania"	Ministria e Arsimit dhe Sportit; Institucionet e formimit profesional; Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2024–2030 organi bashkërendues; të tjerë.	**Afatgjatë** (i integruar në Planin Kombëtar të Veprimit 2026–2030; ndryshim strukturor gjatë 5–10 viteve)	Strategjia Kombëtare e Zhvillimit të Sipërmarrjes Inovative 2024–2030 (shtylla e zhvillimit gjithëpërfshirës); SKZHBI 2021–2027; Kapitulli 20 i legjislacionit të BE-së

R1 dhe R2 janë baza: pa një kuadër të ripërtërirë qeverisjeje dhe pa të dhëna të besueshme të ndara sipas gjinisë, rekomandimet e mbetura nuk mund të monitorohen ose të mbahen përgjegjëse. Ato duhet të trajtohen si prioritete të menjëhershme dhe janë të arritshme brenda kapacitetit ekzistues institucional. R3, R4, R5 dhe R6 vijojnë si thelbi operacional i modelit të mbështetjes. R7, R8 dhe R9 kërkojnë përgatitje më të gjatë, bashkërendim ndërmjet institucioneve ose reformë rregullatore, dhe duhet të zhvillohen paralelisht, por me afate kohore realiste për zbatimin.

SHTOJCAT

SHTOJCA 1. PRAKTIKAT E MIRA NDËRKOMBËTARE

1.1 QËLLIMI I ANALIZËS SË PËRVOJAVE NDËRKOMBËTARE

Ky seksion shqyrton përvojat ndërkombëtare që mund të ndihmojnë Shqipërinë të përmirësojë mbështetjen për gratë sipërmarrëse. Ai përqendrohet veçanërisht te bizneset mikro/të vogla drejtuara nga gratë dhe te gratë që përballen me disavantazhe dhe pengesa më të mëdha. Shqyrtimi analizon zgjidhjet praktike, përfshirë mënyrën se si krijohen programet mbështetëse, si arrijnë ato te gratë dhe çfarë i ndihmon gratë të kenë akses në financim, këshilla biznesi, tregje dhe rrjete profesionale. Fokusi është në shembuj që mund të jenë të dobishëm dhe realistë për kontekstin e vetë Shqipërisë, duke përfshirë prioritetet e zhvillimit në nivel vendor dhe reformat e lidhura me BE-në. Përvoja ndërkombëtare tregon se rezultatet më të forta zakonisht vijnë nga paketat e kombinuara të mbështetjes. Me fjalë të tjera, gratë sipërmarrëse përfitojnë më shumë kur financat lidhen me mentorimin, masat e synuara të përfshirjes dhe të dhënat më të mira, në vend që të mbështeten vetëm në grante të njëhershme ose mbështetje të përgjithshme për biznesin (Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar, 2025) [10].

Praktikat e mira të përfshira në këtë seksion u zgjodhën duke përdorur gjashtë kritere kryesore: sa të rëndësishme janë ato për sipërmarrjen e grave, sa mirë u përgjigjen grave të pafavorizuara dhe të margjinalizuara, nëse mbështeten nga të dhëna të qarta, nëse janë realiste për t'u zbatuar nga institucionet, nëse mund të përshtaten për Shqipërinë dhe nëse lejojnë që progresi të gjurmohet përmes të dhënave me ndjeshmëri gjinore. Këto kritere janë të rëndësishme sepse përvoja ndërkombëtare tregon se programet mund të duken gjithëpërfshirëse në letër, por prapë nuk arrijnë te gratë në praktikë. Kjo zakonisht ndodh kur ato nuk marrin parasysh pengesat reale me të cilat përballen gratë, të tilla si aksesi i kufizuar në kolateral, rrjete më të dobëta profesionale, mungesa e kohës për shkak të përgjegjësive të kujdesit në familje, marketingu më i ulët në mundësitë për investim dhe aksesi më i vogël në prokurimin publik ose tregjet e eksportit. (Banka Britanike e Biznesit, 2025) [11].

1.2 MODELE DHE SHEMBUJ TË PRAKTIKAVE TË MIRA

- **Miratimi i një qasjeje të integruar, të të gjithë qeverisë. Strategjia e Kanadasë për Sipërmarrjen e Grave**[12] ilustron këtë model duke bashkuar mbështetje të bashkërenduar të ekosistemit, programe financimi të përshtatura dhe gjenerim të njohurive të posaçme. Në qendër të nismës është Qendra e Njohurive për Sipërmarrjen e Grave, e cila vepron si një platformë kombëtare për prova, të dhëna dhe të nxënit mbi masa të efektshme mbështetëse. Kjo qasje e bashkërenduar forcon koherencën e politikave, përmirëson aksesin në burime dhe siguron që ndërhyrjet t›u përgjigjen nevojave dhe realiteteve specifike të grave sipërmarrëse.

10. Gov.Uk. (2025). Investing in Women Code annual report 2025. https://www.gov.uk/government/organisations/department-for-business-and-trade
11. Po aty.
12. WES Canada. (2023). Women Entrepreneurship Strategy: Progress Report 2023. https://ised-isde.canada.ca/site/ised/en/programs-and-initiatives/women-entrepreneurship-strategy/women-entrepreneurship-strategy-progress-report-2023

- **Sipërmarrja e grave duhet të trajtohet përmes një ndërthurjeje të shqyrtimit të politikave, reformës së sistemit financiar dhe mbështetjes së synuar me inovacion.** Kjo përvojë vjen nga Mbretëria e Bashkuar, ku Shqyrtimi i Alison Rose-it[13] përcaktoi një drejtim politik afatgjatë duke theksuar shkallën e potencialit ekonomik të parealizuar dhe duke identifikuar pengesat në financime, aftësi, besim dhe përgjegjësi kujdesi. Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar më pas deklaroi një ambicie për të rritur numrin e sipërmarrëseve gra me 50% deri në vitin 2030. Kohët e fundit, Kodi i Investimit te Gratë ka krijuar një kuadër vullnetar tregu përmes të cilit institucionet financiare angazhohen për të përmirësuar aksesin në financa për bizneset e drejtuara nga gratë dhe për të raportuar të dhëna më të mira. Raporti vjetor i vitit 2025 vëren se Kodi kishte arritur 290 firma, duke nënvizuar rëndësinë e mbledhjes së të dhënave dhe të aplikimeve/projekteve për trajtimin e boshllëqeve në financime. Paralelisht, Mbretëria e Bashkuar nisi konkursin "Gratë për avancimin e sipërmarrjes" në vitin 2025[14] për të mbështetur kompanitë e drejtuara nga gratë në fushën teknologjike me potencial të lartë, ndërsa një paketë më e gjerë qeveritare e njoftuar në korrik 2025 përfshinte mbështetje të madhe të synuar për sipërmarrësit e nënpërfaqësuar, përfshirë gratë. Së bashku, këto nisma tregojnë një kombinim të dobishëm të reformës së bazuar në të dhëna, standardeve të të dhënave dhe mbështetjes së synuar të rritjes[15].

- **Lehtësimi institucional përmes qendrave mbështetëse të fokusuara te gratë dhe procedurave të thjeshtuara të biznesit.** Në Shtetet e Bashkuara, Qendrat e Biznesit të Grave të mbështetura nga Administrata e Biznesit të Vogël ofrojnë këshillim dhe trajnim falas ose me kosto të ulët për gratë që kërkojnë të fillojnë, të rrisin ose zgjerojnë bizneset, me vëmendje të veçantë për sipërmarrëset gra të nënpërfaqësuara[16].

- **Banka Kroate për Rindërtim dhe Zhvillim ka mbajtur linjë financimi të dedikuar për sipërmarrjen e grave, duke përfshirë kritere të lidhura me pronësinë dhe lidershipin e grave, dhe produkte specifike të synuara për sipërmarrjen e grave, të të rinjve dhe të startup-eve (bizneseve të reja)[17].** Kroacia ka një përvojë më të gjatë në politika në sipërmarrjen e grave. Të dhënat më të fundit tregojnë gjithashtu një vetëperceptim të fortë sipërmarrës midis grave në krahasim me mesataren e BE-së. Përvoja kroate është e dobishme sepse tregon se si sipërmarrja e grave mund të mbështetet si përmes njohjes në nivel strategjie ashtu edhe përmes instrumenteve financiare të dedikuara për to brenda sistemit kombëtar bankar të zhvillimit.

- **Së fundmi, praktika e mirë ka të bëjë me masat e synuara të përfshirjes.** Paketa e trajnimit "GET Ahead (Ec përpara)" e Organizatës Ndërkombëtare të Punës (ONP) është hartuar për kontekstet e sipërmarrjes me të ardhura të ulëta dhe në shkallë të vogël dhe integron qasje me ndjeshmëri gjinore në trajnimin për sipërmarrjen. Puna e UN Women[18] mbi përgjigjshmërinë gjinore tregon gjithashtu se prokurimi publik dhe institucional mund të projektohet për të zgjeruar pjesëmarrjen e bizneseve në pronësi të grave në vend që të mbetet formalisht asnjanëse, por

13. Department for Business and Trade. (2019). The Alison Rose Review of Female Entrepreneurship. https://www.gov.uk/government/publications/the-alison-rose-review-of-female-entrepreneurship
14. Women Advancing Venture and Entrepreneurship Competition. (2025). UK government competition for women-led technology businesses. https://www.business.gov.uk/campaign/women-advancing-venture-and-entrepreneurship-competition-wave-2025/
15. Department for Business and Trade, & British Business Bank. (2025, July 10). £500m government investment to boost growth and opportunity for underrepresented entrepreneurs. https://www.gov.uk/government/news/500m-government-investment-to-boost-growth-and-opportunity-for-underrepresented-entrepreneurs
16. SBA (2025). https://www.sba.gov/local-assistance/resource-partners/womens-business-centers
17. Croatian Bank for Reconstruction and Development. https://www.hbor.hr/youth-female-start-up-and-other-special-segments-entrepreneurship/405
18. UN WOMEN. (2025). ECA, Women's Entrepreneurship Expo 2025. https://eca.unwomen.org/en/what-we-do/economic-empowerment/womens-entrepreneurship-expo-2025

praktikisht përjashtuese. Për gratë sipërmarrëse që kërkojnë të kenë akses në mundësitë në tregti dhe eksport, "She Trades Outlook" i Qendrës Ndërkombëtare të Tregtisë, ofron një mjet të dobishëm diagnostikues të politikave përmes 55 treguesve në gjashtë shtylla, duke ndihmuar për identifikimin se cilat janë mjediset e biznesit që po i zhgënjejnë gratë.

1.3 MËSIME PËR SHQIPËRINË

Disa mësime dalin vazhdimisht nga këta shembuj ndërkombëtarë dhe rajonalë.

- Politikat e sipërmarrjes formalisht asnjanëse ndaj gjinisë rrallë janë asnjanëse në pasojë; pa masa të qarta korrigjuese, gratë mbeten të pafavorizuara në aksesin në financim, në mbështetje me këshilla, në projekte investimesh dhe në mundësi tregu.

- Sistemet e ofrimit të shërbimeve kanë rëndësi po aq sa qëllimi i politikave. Praktika e mirë kombinon bashkëpunimin mes institucioneve, thjeshtimin e aksesit, zgjerimin e synuar dhe raportimin e matshëm.

- Mbështetja e kombinuar është më e efektshme sesa ndërhyrjet e izoluara: financimet funksionojnë më mirë kur lidhen me shërbimet e këshillimit, mentorimit dhe aksesit në ekosistem.

- Sistemet e të dhënave të përgjigjshme gjinore nuk janë thjesht mjete teknike, por instrumente thelbësore të politikave, sepse e bëjnë përjashtimin të dukshëm dhe u lejojnë institucioneve të gjurmojnë nëse po përfitojnë në të vërtetë sipërmarrjet mikro/të vogla të drejtuara nga gratë.

- Gratë e pafavorizuara dhe të margjinalizuara nuk kanë gjasa të përfitojnë vetëm përmes thirrjeve të hapura të përgjithshme. Ato kërkojnë rrugë të synuara, qasje vendore, ofrim elastik dhe modele mbështetëse të përgjegjshme ndaj varfërisë, disavantazhit territorial, informalitetit, aftësisë së kufizuar, përjashtimit bazuar në etni dhe barrës së kujdesit.

1.4 MUNDËSIA PËR TRANSFERIM DHE PËR PËRSHTATJE PËR SHQIPËRINË

Mësimi më i madh është përshtatja e elementëve të zgjedhur në një paketë koherente politikash. Tre elementë duken veçanërisht të transferueshëm.

- Krijimi i një linje shërbimi të dedikuar për sipërmarrjen e grave brenda arkitekturës kombëtare dhe vendore të mbështetjes së biznesit, duke kombinuar procedurat e thjeshtuara, këshillimin e synuar për gratë dhe pikat hibride fizike-digjitale të aksesit, duke u mbështetur në praktikën e Mbretërisë së Bashkuar, SHBA-së dhe të zyrave me një ndalesë.

- Forcimi i financimit të përgjigjshëm gjinor të NVM-ve përmes një pakete që kombinon aksesin në kredi bankare të bazuar në këshillim, partneritete për zhvillim dhe financim dhe një angazhim kombëtar për raportimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, të frymëzuar nga Kodi i Investimit te Gratë, modeli i "Grave në biznes" i BERZH-it dhe nismat përkatëse europiane.

- Krijimi i një rruge më të qartë gjithëpërfshirjeje dhe rritjeje për bizneset mikro/të vogla të drejtuara nga gratë e pafavorizuara duke kombinuar shtrirjen vendore, trajnimin për sipërmarrje me ndjeshmëri gjinore dhe masat pilot në prokurimin dhe zhvillimin e ofertave të përgjigjshme gjinore.

SHTOJCA 2: PËRMBLEDHJE E TRYEZËS SË KONSULTIMIT ME PALËT E INTERESUARA, 24 PRILL 2026

Përfaqësueset e grave u organizuan në katër tryeza diskutimi sipas sektorëve/grupeve të mëposhtme: tregti, shërbime, bujqësi dhe artizanat. Gjatë diskutimeve ato konfirmuan gjetjet e analizës dhe ndanë gjetjet dhe rekomandimet e mëposhtme.

Gjetjet nga grupi i punës: Tregtia

Diskutimi në grupin e fokusuar te tregtia theksoi se gratë sipërmarrëse kanë nevojë për mbështetje që është më e përshtatur, e thjeshtuar dhe më afër realiteteve të veprimtarisë së tyre të përditshme të biznesit. Pjesëmarrësët theksuan se formatet ekzistuese të mbështetjes shpesh nuk janë mjaftueshëm të arritshme për gratë që drejtojnë biznese mikro dhe të vogla, veçanërisht ato formate me kufizime kohore, njohuri të kufizuara për procedurat ose akses të kufizuar në informacion.

Një çështje e rëndësishme e ngritur ishte nevoja për forma më të thjeshta të komunikimit dhe ndarjes së informacionit që janë më të lehta për t'u kuptuar, më praktike dhe më të arritshme për gratë sipërmarrëse. Pjesëmarrësët vunë në dukje se informacioni mbi shërbimet, programet mbështetëse dhe mundësitë ekzistuese nuk arrin gjithmonë te gratë në mënyrë të efektshme. Për këtë arsye, ato propozuan përdorimin e rrugëve më të larmishme të komunikimit dhe promovimit, duke përfshirë fushatat informuese përmes kanaleve të shumëfishta, materialet promovuese pamore dhe një përdorim më funksional të platformave publike si "e-Albania".

Një tjetër gjetje kyç kishte të bënte me rolin e bashkive dhe strukturave vendore në arritjen te gratë dhe ofrimin e shërbimeve më afër komunitetit. U theksua se bashkitë mund të luajnë një rol më aktiv në udhëzimin, informimin dhe lidhjen e grave me shërbimet ekzistuese, si dhe në ndërtimin e urave të bashkëpunimit me institucione të tjera vendore, shkolla profesionale dhe aktorë të tjerë në ekonominë vendore.

Diskutimi gjithashtu theksoi rëndësinë e një informimi më të mirë mbi aksesin në financim. Pjesëmarrësët theksuan se gratë nuk kanë nevojë vetëm për informacion në lidhje me instrumentet financiare ekzistuese, por edhe për udhëzime praktike dhe mentorim se si mund të përdoren këto instrumente. Në këtë drejtim, mbështetja për financimet duhet të shoqërohet me orientim dhe ndihmë, në mënyrë që gratë të jenë më të përgatitura për të aplikuar dhe për të përdorur në mënyrë të efektshme mundësitë e ofruara për financim. Lidhur me aksesin në treg, grupi theksoi nevojën për mekanizma më aktivë për të ndihmuar gratë të lidhen me konsumatorët dhe kanalet e shitjes. Strukturat e dobishme ndërmjetëse të përmendura përfshinin dhomat e tregtisë, si dhe përdorimin e mediave sociale, influencuesve, televizionit, podkasteve dhe formave të tjera moderne të promovimit. Pjesëmarrësët gjithashtu treguan interes në nxitjen e bashkëpunimit midis grave sipërmarrëse duke krijuar modele të dobishme të bashkëpunimit reciprok. Një ide tjetër e ngritur ishte promovimi i produkteve vendase nën një identitet më të fortë, për shembull përmes qasjeve të tipit "Made in Albania".

Së fundmi, grupi identifikoi si një çështje të rëndësishme nevojën për një trajtim fiskal më elastik për bizneset e vogla të drejtuara nga gratë, duke përfshirë mundësinë e lehtësive tatimore ose rregullimeve më të përshtatshme tatimore që do t'i ndihmojnë këto biznese të formalizohen, të qëndrojnë në treg dhe të rriten gradualisht.

Gjetjet nga grupi i punës: Shërbimet

Grupi i fokusuar te shërbimet theksoi se gratë sipërmarrëse në këtë fushë përballen me vështirësi që lidhen jo vetëm me financimin, por edhe me mungesën e udhëzimeve praktike, edukimit financiar, mbështetjes në marketing dhe rrjetëzimit profesional. Diskutimi tregoi se, për shumë gra, pengesa kryesore nuk është mungesa e gatishmërisë për të rritur biznesin e tyre, por mungesa e mbështetjes së strukturuar dhe të vazhdueshme në faza të ndryshme të zhvillimit të biznesit.

Një gjetje e rëndësishme ishte nevoja për investime më të mëdha në promovimin dhe marketingun e sipërmarrjeve të drejtuara nga gratë. Pjesëmarrëset theksuan se shumë biznese përballen me vështirësi në rritjen e marketingut të tyre dhe zgjerimin e bazës së klientëve të tyre për shkak të njohurive, mjeteve dhe mbështetjes profesionale të kufizuar në këtë fushë. Si rezultat, mbështetja teknike për marketingun, promovimin dhe pozicionimin në treg u konsiderua veçanërisht e rëndësishme.

Grupi theksoi gjithashtu nevojën që gratë sipërmarrëse të kenë një pikë të qartë orientimi, domethënë të dinë se ku të drejtohen për këshilla, informacion dhe shërbime konkrete. Kjo lidhet me nevojën për një sistem referimi më të qartë dhe më të lehtë për t'u përdorur, veçanërisht për gratë që janë në fazat e hershme të sipërmarrjes ose që nuk kanë përvojë të mëparshme në biznes.

Lidhur me financimin, pjesëmarrëset theksuan rëndësinë e kredive të buta, mbështetjen për kapitalin fillestar dhe lehtësimin e kushteve bankare për gratë që hyjnë në sipërmarrje ose që kërkojnë të zgjerojnë veprimtarinë e tyre. U nënvizua se instrumentet financiare duhet të jenë më afër realitetit të sipërmarrjeve mikro dhe të vogla dhe duhet të shoqërohen me kushte më elastike dhe akses më të lehtë.

Një tjetër prioritet i identifikuar ishte edukimi financiar. Pjesëmarrëset propozuan programe më praktike mbi menaxhimin e buxhetit, planifikimin financiar, marketingun dhe strategjinë e biznesit. U vu re se kjo lloj mbështetjeje është veçanërisht e rëndësishme për gratë që kanë filluar biznese bazuar në përvojën praktike, por që nuk kanë pasur mundësinë të zhvillojnë njohuri të strukturuara mbi menaxhimin.

Mentorimi u konsiderua gjithashtu një element kyç. Diskutimi theksoi nevojën për modele mentorimi që fuqizojnë vajzat dhe gratë, i ndihmojnë ato të marrin vendime mbi bazë të të dhënave, të përballen me pasigurinë dhe të ndërtojnë besim në aftësitë e tyre sipërmarrëse. Në këtë kontekst, mentorimi u pa jo vetëm si një transferim i njohurive, por edhe si një mekanizëm për fuqizim dhe vazhdimësi.

Grupi theksoi gjithashtu rëndësinë e rrjetëzimit dhe krijimit të partneriteteve. U vu re se gratë kanë nevojë për më shumë mundësi për t'u lidhur me aktorët e tregut, organizatat profesionale dhe strukturat ndërmjetëse në mënyrë që të ndërtojnë bashkëpunime, të zgjerojnë mundësitë e shitjes dhe të përfitojnë nga shkëmbimi i përvojave.

Së fundmi, diskutimi theksoi rëndësinë e lidhjes së sipërmarrjes me shërbimet e tregut të punës dhe të punësimit, veçanërisht në rastet kur sipërmarrja shihet si një rrugë kalimi nga papunësia në vetëpunësim ose punësim më të qëndrueshëm. Pjesëmarrëset sugjeruan që shërbimet duhet të jenë më të përshtatura me nevojat e grupeve të grave që ato synojnë të mbështesin.

Gjetjet nga grupi i punës: Gratë në bujqësi

Diskutimi në grupin e grave në bujqësi konfirmoi se sipërmarrja e grave në këtë sektor përbëhet nga një kombinim i pengesave ekonomike, sociale, strukturore dhe institucionale. Pjesëmarrëset theksuan se gratë në zonat rurale vazhdojnë të përballen me akses të kufizuar në financime, tregje dhe shërbime mbështetëse, teksa normat shoqërore dhe rolet tradicionale gjinore vazhdojnë të ndikojnë në vetëbesimin, vendimmarrjen dhe pjesëmarrjen e tyre ekonomike.

Një nga çështjet më të theksuara ishte ndikimi i mendësisë dhe stereotipave shoqërorë. Sipas pjesëmarrëseve, normat shoqërore vazhdojnë të kufizojnë pjesëmarrjen aktive të grave në sipërmarrje, veçanërisht në zonat rurale, ku gratë shpesh përballen me pritshmëritë tradicionale në lidhje me rolin e tyre në familje dhe komunitet. Kjo lidhet gjithashtu me vetëbesimin më të ulët dhe frikën nga dështimi, të cilat të dyja ndikojnë në gatishmërinë e grave për të filluar ose zgjeruar veprimtaritë ekonomike.

Diskutimi konfirmoi gjithashtu se gratë në bujqësi kanë akses më të kufizuar në financim. Pjesëmarrëset përmendën vështirësitë për sigurimin e kredive bankare, kriteret e granteve që nuk janë gjithmonë të përshtatshme për realitetin rural dhe mungesën e instrumenteve financiare të përshtatura për gratë. Ato nënvizuan nevojën për kredi të buta, skema kombëtare mbështetëse për gratë, kredi pa kolateral dhe grante nga pushteti vendor, duke përfshirë mundësinë e skemave mbështetëse të ofruara nga bashkitë.
Një tjetër gjetje e rëndësishme ishte qasja e kufizuar në tregje. Pjesëmarrëset theksuan se gratë përballen me vështirësi në organizimin kolektiv, në lidhjen me blerësit dhe në hyrjen në tregje më të gjera. Ato e konsideruan të nevojshme forcimin e grave përmes organizimit në grupe, grupime ose shoqata, si dhe përmes trajnimeve që ndihmojnë në standardizimin, certifikimin, paketimin dhe etiketimin e produkteve. Lidhjet me tregjet përmes panaireve, kontratave të shitjes, qendrave të grumbullimit ose inkubatorëve kolektivë u panë gjithashtu si të rëndësishme.

Grupi gjithashtu vuri në dukje kushtet më të vështira të punës dhe infrastrukturën sociale ende të dobët në zonat rurale. Mungesa ose pamjaftueshmëria e shërbimeve të tilla si çerdhet dhe kopshtet, së bashku me barrën e kujdesit në familje dhe punën e papaguar, u identifikuan si faktorë që kufizojnë kohën dhe mundësitë e grave për t'u angazhuar më plotësisht në veprimtarinë ekonomike. Kjo tregon se sipërmarrja e grave në bujqësi nuk mund të trajtohet vetëm si një çështje prodhimi ose tregjesh, por edhe si një çështje e infrastrukturës sociale dhe shpërndarjes së pabarabartë të punës së kujdesit.

Një tjetër përparësi e ngritur nga pjesëmarrëset ishte nevoja për zhvillimin e aftësive dhe kapaciteteve. U theksua se gratë kanë nevojë për më shumë mbështetje në përpunimin, standardizimin, marketingun, paketimin dhe etiketimin e produkteve, si dhe për më shumë udhëzime praktike mbi zhvillimin e biznesit. Mungesa e organizimit në grupe u vu re gjithashtu si një pengesë shtesë, pasi kufizon mundësitë për bashkëpunim, ndarjen e përvojave dhe fuqizimin kolektiv.

Sa u përket rekomandimeve, grupi theksoi nevojën për programe që synojnë fuqizimin e grave dhe vajzave, rritjen e vetëbesimit, rritjen e ndërgjegjësimit për stereotipat gjinorë dhe ofrimin e mbështetjes së strukturuar në financime, aksesin në treg dhe zhvillimin e kapaciteteve. Diskutimi tregoi qartë se gratë në bujqësi kanë nevojë për një qasje të integruar që kombinon financimin, organizimin kolektiv, lidhjet me tregun, trajnimin praktik dhe masat që rregullojnë kufizimet sociale dhe familjare.

Gjetjet nga grupi i punës: Artizanati

Diskutimi në grupin e artizanatit tregoi se gratë e angazhuara në këtë fushë përballen me një kombinim të vështirësive financiare, fiskale, tregtare dhe organizative që kufizojnë qëndrueshmërinë dhe zgjerimin e veprimtarive të tyre. Pjesëmarrësët theksuan se artizanati mbetet një fushë e rëndësishme me potencial të fortë për fuqizimin ekonomik të grave, por që aktualisht nuk mbështetet mjaftueshëm përmes instrumenteve të përshtatura.

Një nga gjetjet kryesore ishte mungesa e aksesit në financim. Pjesëmarrësët nënvizuan se gratë dhe burrat artizanë përballen me vështirësi në sigurimin e mbështetjes financiare për të filluar, mbajtur ose zgjeruar veprimtarinë e tyre. Kjo lidhet me shkallën e vogël të biznesit, informalitetin në disa raste dhe mungesën e instrumenteve financiare të përshtatura për sektorin e artizanatit.

Grupi gjithashtu theksoi vështirësitë dhe barrën fiskale që lidhen me tatimet. U theksua se regjimi ekzistues i tatimeve nuk është gjithmonë i përshtatshëm për realitetin ekonomik të grave artizane dhe se nevojiten mënyra më elastike në mënyrë që të mos dekurajohet formalizimi dhe vazhdimësia e veprimtarisë të tyre. Një çështje tjetër e rëndësishme ishte konkurrenca e padrejtë nga produktet joartizanale ose produktet e importuara me kosto më të ulëta, të cilat e bëjnë më të vështirë për prodhimin vendas të zërë vend në treg. Pjesëmarrësët theksuan gjithashtu mungesën e një tregu të organizuar dhe të qëndrueshëm për produktet artizanale, duke përfshirë mungesën e platformave të shitjes që do të ofronin marketing më të madh dhe mundësi më të forta shitjeje.

Informaliteti u identifikua si një problem tjetër i rëndësishëm, pasi kufizon aksesin në mbështetje, financim, tregje më të strukturuara dhe mundësi zhvillimi afatgjatë. Pjesëmarrësët ngritën gjithashtu çështjen e mbështetjes së pamjaftueshme nga bashkitë dhe aktorët vendorë, duke sugjeruar që strukturat vendore të mund të luajnë një rol më aktiv në promovimin e artizanatit dhe mbështetjen e grave artizane.

Diskutimi theksoi gjithashtu nevojën për më shumë mundësi për të marrë pjesë në panaire ndërkombëtare dhe për mbështetje më të madhe financiare që do t'u mundësonte grave artizane të prezantonin produktet e tyre në tregje më të gjera. Gjithashtu u konsiderua e vlefshme të krijoheshin nisma të tipit "mjeshtre artizanale" që synojnë transmetimin e aftësive artizanale te brezi i ri, si dhe hapjen e skemave të granteve për mentorim dhe për ruajtjen e vazhdimësisë së aftësive artizanale.

Një tjetër rekomandim i rëndësishëm ishte nxitja e shkëmbimit të përvojave ndërkombëtare, duke përfshirë vizitat studimore, si dhe forcimi i grupeve ekonomike që veprojnë në sektorin e artizanatit. Në këtë kontekst, pjesëmarrësët propozuan gjithashtu krijimin e një shoqate kombëtare të grave dhe burrave artizanë, e cila mund të shërbejë si një strukturë përfaqësuese, një platformë për bashkëpunim dhe një mekanizëm advokimi për interesat e këtij sektori.

Në përgjithësi, diskutimi tregoi se mbështetja për gratë artizane duhet të jetë më e strukturuar dhe më e përshtatur me karakteristikat specifike të sektorit. Kjo përfshin përmirësimin e aksesit në financim, trajtimin fiskal më realist, mekanizma më të fortë për të hyrë në treg, mbështetje nga njësitë e qeverisjes vendore, promovimin e prodhimit artizanal vendas dhe nisma që forcojnë organizimin kolektiv dhe transmetimin e aftësive te brezat e rinj.

BIBLIOGRAFIA

1. British Business Bank. (2025a). Investing in Women Code.
2. British Business Bank. (2025b). Investing in Women Code annual report 2025.
3. Department for Business and Trade, & British Business Bank. (2025, July 10). £500m government investment to boost growth and opportunity for underrepresented entrepreneurs. https://www.gov.uk/government/news/500m-government-investment-to-boost-growth-and-opportunity-for-underrepresented-entrepreneurs
4. Department for Business and Trade. (2019). The Alison Rose Review of Female Entrepreneurship.
5. Komisioni Europian. (2024). *Raporti për Shqipërinë 2024*.
6. Komisioni Europian. (2025). *Raporti për Shqipërinë 2025*.
7. European Bank for Reconstruction and Development. (n.d.). Women in Business.
8. European Bank for Reconstruction and Development. (2025). Western Balkans Women in Business Programme Phase II – KRK (EFSD+).
9. Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim. (2023). *"Vlerësimi i Mjedisit për Sipërmarrjen e Grave" në Shqipëri: Një studim për gratë sipërmarrëse në Shqipëri*.
10. Qendra e Aleancës Gjinore për Zhvillim (GADC). (2024). *Analiza me ndjeshmëri gjinore e Zinxhirit të Vlerës: Sektori i veshjeve në Shqipëri*. Tirana: GADC / Bashkia Tiranë, me mbështetjen e Fondit të Veprimit për Barazi Gjinore (GEEA), U.S. Department of State.
11. Qeveria e Shqipërisë. (2024). *Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e Sipërmarrjes Inovative 2024–2030*.
12. Government of Croatia. (2014). Strategy of Women Entrepreneurship Development in the Republic of Croatia 2014–2020.
13. Hoxha, B. (2025, December 6). Kriza pa kthesë e fasonerisë [The irreversible crisis of fason]. *Monitor.al*. https://monitor.al/kriza-pa-kthese-e-fasonit-2/
14. INSTAT. (2024). *Censi i Popullsisë dhe Banesave në Shqipëri 2023*.
15. INSTAT. (2025). *Regjistrat e Biznesit 2024*.
16. INSTAT. (2025). *Tregu i Punës në Shqipëri 2024*.
17. INSTAT. (2025). *Gratë dhe Burrat në Shqipëri 2024*.
18. International Labour Organization. (2023). GET Ahead resources.
19. International Trade Centre. (2025a). SheTrades Outlook.
20. International Trade Centre. (2025b). SheTrades Initiative.
21. OECD. (2025). Inclusive entrepreneurship policy assessment country note: Croatia.
22. Regional Cooperation Council. (2023a). Women entrepreneurship in the Western Balkans: Economy factsheets.
23. Regional Cooperation Council. (2023b). Women entrepreneurship in the Western Balkans: Stocktaking on constraints and good practices.
24. *Drejt një Ekosistemi të Sipërmarrjes me Përfshirje Gjinore: Sfidat dhe Mundësitë për Gratë në Shqipëri* (Draft, korrik 2025).
25. U.S. Small Business Administration. (2025). Women's Business Centers.
26. UN Women. (2022). Building gender-responsive procurement: Lessons from global practice.
27. UN Women Europe and Central Asia. (2025). Women's Entrepreneurship EXPO 2025.
28. Women Advancing Venture and Entrepreneurship Competition. (2025). UK government competition for women-led technology businesses. https://www.business.gov.uk/campaign/women-advancing-venture-and-entrepreneurship-competition-wave-2025/
29. WES Canada. (2023). Women Entrepreneurship Strategy: Progress Report 2023. https://ised-isde.canada.ca/site/ised/en/programs-and-initiatives/women-entrepreneurship-strategy/women-entrepreneurship-strategy-progress-report-2023

UN WOMEN ËSHTË KRIJUAR PËR TË AVANCUAR TË DREJTAT E GRAVE, BARAZINË GJINORE DHE FUQIZIMIN E TË GJITHA GRAVE DHE VAJZAVE.

UN Women është krijuar për të avancuar të drejtat e grave, barazinë gjinore dhe fuqizimin e të gjitha grave dhe vajzave. Si enti drejtues i Kombeve të Bashkuara për barazinë gjinore dhe sekretariat i Komisionit për Statusin e Grave, ne punojmë për të ndryshuar ligjet, institucionet, sjelljet shoqërore dhe shërbimet, me qëllim mbylljen e hendekut gjinor dhe ndërtimin e një bote të barabartë për të gjitha gratë dhe vajzat. Partneritetet tona me qeveritë, lëvizjet e grave dhe sektorin privat, së bashku me rolin tonë koordinues në kuadër të sistemit të Kombeve të Bashkuara, i kthejnë përparimet në ndryshime të qëndrueshme. Puna jonë për avancimin e të drejtave të grave dhe vajzave përqendrohet në katër fusha kyçe: lidershipi, fuqizimi ekonomik, mbrojtja nga dhuna, roli i grave në paqe dhe siguri, si dhe veprimi humanitar. UN Women i vendos të drejtat e grave dhe vajzave në qendër të përparimit global—gjithmonë dhe kudo. Sepse barazia gjinore nuk është vetëm ajo që bëjmë. Barazia gjinore është ajo që jemi.

UN WOMEN

FOR ALL WOMEN AND GIRLS

Str. Skenderbej, P. 8, 2nd floor, Ap. 29,30,31, Tirana, Albania

albania.unwomen.org
facebook.com/unwomenalbania
instagram.com/unwomenalbania